



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.03.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtares {...}, (relatore znj. Yllka Rupa).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 15:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami* si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Rezarta Taushani dhe Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Të tjerë: Edmond Hoxhaj (BIRN).*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtares {...}”, (relatore znj. Yllka Rupa).

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë, dhe për shkak të kuorunit, deklaroj të hapur mbledhjen e sotme.

Ndërkohë, ju bëj me dije që Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për arsye objektive të justifikuara, e ka të pamundur për të qenë prezent sot. Tani dhe në vijueshmëri, mbledhjen do ta drejtoj unë.

Sipas rendit të ditës, fjalën ia jap zonjës Rupa në lidhje me pikën 1 të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013

– 2016, të gjyqtares {...}.

Yllka Rupa: Faleminderit!

Të nderuar kolegë, në cilësinë e relatores do të paraqesë projektvendimin që ka për qëllim vlerësimin e gjyqtares {...} për periudhën 2013-2016.

Procedura e vlerësimit të gjyqtares {...} ka filluar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.440, datë 01.11.2022, pas dërgimit të dosjeve me aktet e vlerësimit profesional nga organet e rivlerësimit kalimtar. Me këtë vendim, pas shortit të realizuar, janë përzgjedhur vlerësuesit, relatorja dhe nëpunësja përgjegjëse për vlerësim znj.Esmerilda Habili.

Në vijim procedura ka vazhduar me njoftimin e gjyqtares për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për vlerësuesit e përzgjedhur në bazë të shortit dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e tyre, ose të çdo anëtari të Këshillit. Gjyqtarja ka konfirmuar marrjen e njoftimit dhe ka deklaruar se është dakord me vlerësuesit, si dhe nuk ka kërkesë për përjashtimin e tyre ose të ndonjë anëtari të Këshillit.

Pas evidentimit të çështjeve dhe vendimeve të administruara në dosjen e rivlerësimit nga ana e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, relatori ka disponuar për zhvillimin e shortit. Kështu në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë është zhvilluar shorti për përzgjedhjen e 6 (gjashtë) çështjeve për vlerësim.

Pas administrimit të dosjeve të përzgjedhura, ka filluar hartimi i projektraportit të vlerësimit për gjyqtaren i cili është njoftuar dhe brenda afatit dyjavor ajo ka paraqitur kundërshtime në lidhje me raportin e vlerësimit.

Konkretisht gjyqtarja paraqiti kundërshtime për me kriterin e “Aftësive Organizative”, lidhur me treguesit “Respektimi i afateve ligjore” dhe “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit”, si dhe për kriterin “Aftësisë personale dhe angazhimi profesional” lidhur me treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”. Kundërshtimet i ka shoqëruar edhe me provat përkatëse.

Analiza e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit është pasqyruar në mënyrë të plotë kështu që unë do të ndalem në mënyrë të përmbledhur në konkluzionet dhe në nivelin e pikëzimit dhe vlerësimit të kësaj gjyqtareje në katër kriteret e vlerësimit, bashkë me komponentët përkatës.

Në lidhje me “Njohuritë ligjore”, “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” –

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshje dhe për këtë arsye në projektraportin e vlerësimit është propozuar që gjyqtarja të vlerësohet dhe pikëzohet me 25 pikë.

“Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” -

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën e Gjykatës Kushtetuese si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës. Për këto arsye, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

“Arsyetimi ligjor”, “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”-

Evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike. Në lidhje me këtë komponent vlerësoj dhe gjykoj se kjo gjyqtare duhet të vlerësohet në nivelin “Shumë të lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

“Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” -

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e vendimit gjyqësor. Në këto kushte propozoj që niveli i pikëzimit për këtë tregues të jetë 10 pikë.

“Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”-

Referuar të dhënave rezulton se arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe u jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse, si në çështjet civile, ashtu edhe në çështjet penale. Referuar këtij konkluzioni, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues, duhet të jetë “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Në mënyrë të përmbledhur, propozimi në lidhje me nivelin e pikëzimit dhe vlerësimi për treguesin e parë “Aftësitë Profesionale të Gjyqtares” propozoj të jetë 100 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Për të kaluar tek kriteri tjetër që lidhet me “Aftësitë organizative të gjyqtares”,

“Aftësia e gjyqtares për të përballuar ngarkesën në punë”, “Respektimi i afateve ligjore” -

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 2 (dy) prej tyre parashikohet afat ligjor për shqyrtimin e

çështjes. Konkretisht:

(i) Çështja e kategorisë “Familjare me palë kundërshtare”, me objekt “Lëshim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes”, për të cilën është parashikuar si afat ligjor afati 48 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykate, sipas nenit 18 pika 1 e ligjit nr. 9669, datë 17.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar. Rezulton se gjykimi i kësaj çështjeje për “Lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes” ka përfunduar brenda 24 orëve nga regjistrimi i çështjes, në intervalin kohor 26.01.2016 - 27.01.2016. Pra, çështja rezulton të jetë shqyrtuar brenda afatit ligjor prej 48 orësh.

(ii) Çështja civile me objekt “Kundërshtimin e veprimeve përmbarimore”, e cila sipas nenit 610 të K.Pr.Civile parashikon një afat prej 20 ditësh për përfundimin e saj. Referuar akteve të dosjes rezulton se çështja është regjistruar në gjykatë në datën 13.08.2015, dhe me shortin e datës 23.11.2015 i ka kaluar për gjykim gjyqtarës {...}, pas përjashtimit të gjyqtarit të mëparshëm. Me vendimin e datës 23.11.2015, gjyqtarja ka caktuar seancën përgatitore në datën 09.12.2015 (pas 16 ditësh) për shqyrtimin e kërkesës për pezullimin e veprimeve përmbarimore (martjen e masës së sigurimit të padisë sipas objektit), seancë e cila është caktuar tej afatit 5-ditor të parashikuar nga nenin 510, paragrafi 2 i K.Pr.Civile. Po kështu, referuar vendimit nr. 58, datë 04.02.2016 rezulton se nga data e caktimit të çështjes me short gjyqtarës dhe deri në datën e përfundimit të saj 04.02.2016, çështja ka përfunduar për 73 ditë, pra tej afatit 20-ditor të parashikuar në ligj.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër në të cilat vetëm për dy prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre dhe se vetëm në 1 çështje rezulton që gjyqtarja të ketë shkelur afatin ligjor për përfundimin e saj, rezulton se raporti i shprehur në përqindje është 50% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja matematikore prej 50% përkon me nivelin e vlerësimit 3 pikë. Megjithatë, përveç analizës matematike, vlerësuesi duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështjet që nuk janë

përgjegjësi e gjyqtarit. Referuar akteve të dosjes, evidentohet se tejkalimi i afatit ligjor në çështjen e gjykuar jashtë afatit ka ardhur përgjithësisht për shkaqe procedurale, ku seancat janë shtyrë për shkaqe të tilla si: njoftimin e rregullt të personit të tretë; për t'u shprehur gjykata në lidhje me kërkesën e palës paditëse për shtimin e objektit të padisë; për t'i dhënë kohë palëve për të paraqitur konkluzionet përfundimtare me shkrim, si dhe për të shtyrë shpalljen e arsytuar të vendimit. Duke qenë një çështje e vetme, nuk mund të konsiderohet si tregues i saktë dhe absolut mbi aftësinë e gjyqtarës për respektimin e afateve ligjore por, nga ana tjetër, evidentohet se një fakt tjetër që ka ndikuar në tejkalimin e afatit ligjor të shqyrtimit të çështjes ka qenë planifikimi i seancave tej një afati të arsyeshme.

Referuar sa më sipër, në projektraportin e vlerësimit në cilësinë e relatores, lidhur me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, duke pasur parasysh edhe shkaqet që kanë ndikuar në këtë tregues, është propozuar që gjyqtarja të vlerësohet në nivelin “21-30%”, duke e pikëzuar me 9 pikë, pasi gjyqtarja duhej të ishte treguar më efektive në menaxhimin dhe kontrollimin e procedurave gjyqësore.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja ka paraqitur kundërshtimet si vijon:

Konkluzioni lidhur me treguesin “Respektimi i afateve ligjore” në nivelin 21-30%, është arritur nga relatorja bazuar vetëm në një çështje civile. Konkretisht, bëhet fjalë për çështjen civile me Nr. akti 156/809, datë regjistrimi 13.08.2015. Gjykimi në lidhje me këtë çështje ka përfunduar më datë 04.02.2016 me anë të vendimit nr.58, ku në përfundim është vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë. Sipas relatores gjykimi i kësaj çështjeje ka përfunduar tej afatit 20-ditor që parashikonte neni 610 i K.Pr.Civile, si dhe vendimi në lidhje me kërkesën për pezullimin e veprimeve përmbarimore është dhënë tej afatit. Por, vlerësoj se nga ana e relatores në lidhje me këtë çështje duhet të ishin marrë në konsideratë këto rrethana dhe fakte:

1. Çështja civile është regjistruar me datë 13.08.2015 dhe ka kaluar pranë meje me datë 23.11.2015, duke qenë se deri në këtë datë ka qenë për gjykim pranë një tjetër gjyqtari, i cili është përjashtuar me pas nga gjykimi. Si rrjedhojë, respektimi i afatit 20-ditor që parashikonte neni 610 i K.Pr.Civile është tejkaluar prej kohësh nga gjyqtari

tjetër.

2. Është e vërtetë që neni 610 i K.Pr.Civile në kohën e shqyrtimit të padisë parashikonte që ankimi shqyrtohet nga gjykata brenda 20 ditëve, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë palët. Në rastin konkret, nga ana ime është vlerësuar që duhet të thirren edhe palët. Një vendim i tillë është marrë bazuar edhe në faktin se edhe gjyqtari paraardhës ka zhvilluar seancat gjyqësore në prezencë të palëve dhe si rrjedhojë me ndryshimin e trupit gjykues, palëve nuk mund t'ju mohohet kjo e drejtë.

3. Është e vërtetë që edhe vendimi në lidhje me kërkesën për të marrë masën e pezullimit të veprimeve përmbarimore është dhënë përtej afatit ligjor. Por, nga ana e relatores krahas faktit të tejkalimit të këtij afati duhet të ishte marrë në konsideratë edhe fakti se ky afat është kaluar prej gjyqtarit paraardhës. Gjithashtu, duhet të ishte marrë në konsideratë se neni 610 i K.Pr.Civile nuk parashikonte afat të posaçëm për t'u shprehur në lidhje me kërkimin për pezullimin e ekzekutimit, që nënkupton se mund të merret në shqyrtim brenda 20 ditëve, ashtu si vetë kërkitimi kryesor. Kjo praktikë është e njohur dhe e zbatueshme gjerësisht nga gjyqtarët. Madje, relatorja ka cituar se: Gjkata nuk ka respektuar afatin 5-ditor të parashikuar nga neni 510, paragrafi i dytë i K.Pr.Civile, ndërkohë që as neni 510 dhe as neni 610 i K.Pr.Civile nuk parashikon afat 5-ditor për marrjen në shqyrtim të kësaj kërkesë.

Gjithsesi, përveç këtij fakti si dhe mosmarrjes dijeni rregullisht nga personi i tretë, citoj se ka qenë vetë pala paditëse që ka kërkuar që seanca e datës 09.12.2015 të mos zhvillohej, por të shtyhej me qëllim njoftimin e personit të tretë, duke qenë se e ka vlerësuar të domosdoshme prezencën e tij në proces. Në lidhje me këtë kërkim të paditësit, duhet të theksohet se është një kërkesë që duhej pranuar nga gjykata (siç edhe ka ndodhur) sepse është vetë pala paditëse që vë në lëvizje gjykatën dhe ka të drejtën që në seancën e parë të kërkojë njoftimin e palës tjetër edhe në rast të marrjes dijeni rregullisht. Si rrjedhojë, çmoj se nëse seanca do kishte vazhduar pa u njoftuar rregullisht të gjitha palët dhe pa marrë në konsideratë kërkimin e palës paditëse për njoftimin e personit të tretë, do sillte si pasojë shkelje të dispozitave procedurale civile për njoftimin dhe prezencën e palëve në proces. Pra, vetë pala paditëse nuk e ka konsideruar të

domosdoshme që gjykata të shprehej me vendim për kërkesën për masën e pezullimit të veprimeve përmbartimore. Kam vlerësuar se vetë pala paditëse ka të drejtën e disponimit në lidhje me këtë fakt, duke qenë se kjo palë ka të drejtën që në çdo moment të heqë dorë nga kërkitimi për marrjen e masës së pezullimit dhe gjykimi nuk duhet të vijojë domosdoshmërisht në marrjen e një vendimi përfundimtar për këtë kërkitim. Si rrjedhojë, vazhdimi i gjykimit pa u njoftuar rregullisht të gjithë palët dhe pa marrë parasysh kërkesën e palës paditëse për njoftimin e personit të tretë dhe shtyrjen e seancës do të përbënte shkelje. Nuk mund t'i jepet përparësi vendimmarrjes brenda afatit dhe të anashkalohej njoftimi i rregullt i palëve. Nëse gjykata do të vazhdonte seancën pavarësisht këtij fakti, a nuk do të konsiderohej si shkelje?

4. Gjithashtu, duhet të mbahet në konsideratë se pala paditëse nuk ka pasur asnjë pretendim në lidhje me kohëzgjatjen e gjykimit dhe marrjen e vendimeve. Pala paditëse nuk ka paraqitur fare ankim në lidhje me vendimin për marrjen e masës së pezullimit. Ndërsa, në lidhje me vendimin përfundimtar nuk ka parashtruar si shkak kohëzgjatjen e gjykimit.

5. Tjetër fakt që duhet të mbahet parasysh është edhe ngarkesa që unë kam pasur gjatë asaj periudhe, ku pavarësisht se jam emëruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në muajin tetor 2015, rezulton se deri në fund të vitit 2015 kam dhënë mbi 200 vendime. Madje, pavarësisht këtij fakti, sërish seancat gjyqësore në lidhje me këtë çështje janë caktuar afër njëra tjetrës dhe jo në ndonjë distancë shumë të largët.

Gjithashtu, vlerësoj se neni 610 i K.Pr.Civile parashikonte se ankimi merrej në shqyrtim brenda afatit 20-ditor, por nuk nënkuptonte që vendimi duhet të merrej domosdoshmërisht brenda këtij afati.

Lidhur nga sa parashtrohet nga gjyqtarja, evidentohet se vetë gjyqtarja në pjesën përshkruese arsyetueses të vendimit të ndërmjetëm “Për sigurimin e padisë” argumenton se “Bazuar në nenin 202 të K.Pr.Civile e cila parashikon se: “... gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë...” caktoi seancën për shqyrtimin e kësaj kërkesë më datë 09.12.2015, duke mos respektuar kështu afatin e parashikuar nga ligji”. Afati i cili referuar akteve të dosjes nuk evidentohet të jetë respektuar, pasi nga data e

caktimit të çështjes me short dhe datës së caktimit të seancës përgatitore kanë kaluar 16 ditë.

Për sa i përket argumenteve lidhur me ecurinë procedurale të çështjes, në projektraportin e vlerësimit nuk është bërë veç analizë matematikore, por është bërë edhe një analizë logjike e të dhënave duke shmangur përgjegjësit që nuk janë të gjyqtari, dhe pikërisht për këtë arsye gjyqtarja është propozuar të pikëzohet dy nivele më lart se ai që i përket përqindjes së pikëzimit.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se nuk ka vend për ndryshimin e propozimit lidhur me nivelin e vlerësimit, duke i qëndruar propozimit të bërë në projektraportin e vlerësimit, pra në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, gjyqtarja vlerësoj se duhet të vlerësohet në nivelin “21-30%”, duke e pikëzuar me 9 pikë, pasi edhe pse ka 1 (një) çështje të përfunduar tej afatit ligjor të parashikuar dhe kalimi i këtij afati është bërë kryesisht për shkaqe procedurale, në funksion të zgjidhjes sa më shpejt të çështjes, gjyqtarja duhej të kishte menaxhuar dhe kontrolluar në mënyrë me efektive procedurat gjyqësore.

Për të kaluar tek komponenti tjetër që është “Plotësimi i standardeve minimale kohore” –

Evidentohet se në çështjet e vëzhguara për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, rezultoi se të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor të përcaktuar në vendimin 261/2 të ish-KLD-së. Referuar këtij konkluzioni, propozoj që vlerësimi për këtë komponent të jetë maksimal me 5 pikë.

“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”

Në tërësi, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor. Për këtë arsye, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues duhet të vlerësohet e maksimalisht, duke u pikëzuar me 5 pikë.

“Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore”-

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 94.5%. Po kështu sipas të dhënave statistikore konstatohet

se ngarkesa sasiore e gjyqtares {...} ka plotësuar standardin minimal sasior në fuqi dhe e ka tejkaluar atë me 96%. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 8 pikë. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: “Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.” Nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja brenda të njëjtit vit kalendarik, ka gjykuar më shumë se 50% të standardit minimal sasior në fuqi, duke konkluduar në një nivel më të lartë pikëzimi. Pra, gjyqtarja bazuar në këtë parashikim dhe në analizën statistikore si më sipër, duhet të pikëzohet me 10 pikë.

“Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor” është komponent i cili është kundërshtuar nga ana e gjyqtares për sa i përket nivelit të pikëzimit.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Po ashtu e njëjta situatë po t’i referohemi Kodit të Procedurës Civile.

Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10-ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

- a) Dosja 1 (çështje penale), që i përket vendimit me nr.18, datë 15.01.2016, është dorëzuar për 5 ditë, brenda afatit 10-ditor;
- b) Dosja 2 (çështje civile), është dorëzuar për 19 ditë, jashtë afatit 10-ditor;
- c) Dosja 3 (civile familjare), që i përket vendimit me nr.12, datë 27.01.2016 është dorëzuar në datën 01.02.2016 - (5 ditë), brenda afatit 10-ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;

d) Dosja 4 (çështje penale), që i përket vendimit me nr. 1125, datë 05.05.2014 është dorëzuar në datën 09.05.2014 - (4 ditë), brenda afatit 10-ditor të parashikuar në ligj;

e) Dosja 5 (civile marrëdhënie pune), që i përket vendimit me nr.5197, datë 25.04.2014 është dorëzuar në datën 08.05.2014 - (13 ditë), jashtë afatit 10-ditor;

f) Dosja 6 (çështje penale), që i përket vendimit me nr.219, datë 12.07.2016 është dorëzuar në datën 29.07.2016 - (17 ditë), jashtë afatit 10-ditor, të parashikuar në ligj;

g) Dosja 7 (çështje penale), që i përket vendimit me nr. 448, datë 09.12.2015 është dorëzuar në datën 24.12.2015 - (15 ditë), jashtë afatit 10-ditor;

h) Dosja 8 (civile themeli), që i përket vendimit me nr.164, datë 23.03.2016 është dorëzuar në datën 31.03.2016 - (8 ditë), brenda afatit 10-ditor të përcaktuar në K.Pr.Civile;

i) Dosja 9 (civile themeli), që i përket vendimit me nr.58, datë 04.02.2016 është dorëzuar në datën 18.02.2016 - (14 ditë), jashtë afatit 10-ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;

j) Dosja 10 (civile themeli), që i përket vendimit me nr.355, datë 31.05.2016 është dorëzuar në datën 23.06.2016 - (23 ditë), jashtë afatit 10-ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;

k) Dosja 11 (çështje civile familjare), që i përket vendimit me nr.400, datë 16.06.2016 është dorëzuar në datën 22.06.2016 - (6 ditë), brenda afatit-10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për çështjet e kategorisë “Penale” është 10.2 ditë; për kategorinë “Civile themeli” është 15 ditë; për kategorinë e çështjeve “Familjare me palë kundërshtarë” është 5.5 ditë. Pra, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton “Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve”.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja në kundërshtimet e saj ka kërkuar pikëzimin maksimal duke parashtruar se:

Data e dorëzimit të vendimeve të sipërcituara i referohet datës së dorëzimit të vendimit gjyqësor të arsyetuar (dosjes gjyqësore) nga ana e sekretares gjyqësore pranë kryesekretarisë gjyqësore. Kjo datë nuk është e njëjta me datën e dorëzimit të vendimit të arsyetuar nga gjyqtari tek sekretarja gjyqësore. Sekretaret gjyqësore kanë afatin e nevojshëm për të përgatitur dosjen dhe për ta dorëzuar në kryesekretari, që është 5 ditë (kjo e përcaktuar edhe në rregulloren e gjykatës). Si rrjedhojë, vlerësoj që duhet të mbahet në konsideratë edhe ky fakt.

Edhe nëse merren të mirëqena afatet e mësipërme, lehtësisht konstatohet se kanë kaluar shumë pak ditë nga afati që relatorja ka vlerësuar që duhet të ishte respektuar nga ana ime për arsyetimin e vendimit.

Gjithashtu, duhet të mbahet parasysh ngarkesa që unë kam pasur, ku kam gjykuar dhe dhënë vendime për më shumë se 5000 çështje gjatë periudhës 2013-2016. Çdo ditë kam pasur më shumë se 20 seanca gjyqësore, çdo javë kam shpallur mbi 30 vendime dhe normalisht edhe mundësia e koha për të kapur çdo afat ka qenë absolutisht e pamundur.

Nuk ka ardhur asnjë pasojë nga dorëzimi i vendimeve të arsyetuara pak ditë me vonesë dhe në asnjë moment nuk është pretenduar dhe nuk ka qenë objekt ankimi nga ana e palëve, qoftë në gjykatën e apelit.

Pas kundërshtimeve të paraqitura nga gjyqtarja, pavarësisht analizës matematikore, si më sipër, referuar asaj logjike, ku vlerësuesi mban në konsideratë faktin se për kategorinë “Çështje civile” tejkalimi është vetëm me 5 ditë, si dhe referuar edhe ngarkesës në punë të gjyqtarës, duke aplikuar koeficientin 20% të rritjes me 1 shkallë pikëzimi, për këtë kriter propozoj që gjyqtarja duhet të pikëzohet maksimalisht, pra me 15 pikë (referuar të gjitha pretendimeve që ka paraqitur gjyqtarja në parashtrimet e veta).

“Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore”, “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive” –

Për këtë tregues, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 4 seanca, por nga ana tjetër gjyqtarja ka treguar

shkallën e kujdesit maksimal për shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi, prandaj në projektraportin e vlerësimit propozoj që për këtë komponent gjyqtarja duhet të vlerësohet me 15 pikë, në nivelin maksimal.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”-

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët me përjashtim të një dosje në të cilën, gjyqtarja nuk ka respektuar afatin 5 ditë të njoftimit të palëve, në kushtet kur pjesë e objektit të padisë ishte dhe kërkesa e palës paditëse për sigurimin e padisë, në referim të nenit 202 të K.Pr.Civile.

Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet civile ashtu edhe në çështjet penale.

Në dosje të vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa 2 deri në 15 minuta që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore. Megjithatë konstatohen dhe raste të fillimeve të seancave me vonesë, kryesisht për shkak të zgjatjes tej parashikimeve të seancës pararendëse.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe efijencës së treguar nga gjyqtarja në kryerjen e veprimeve për fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Në 11 seancat e filluara me vonesë, referuar relatimit të gjyqtares, në shumicën prej tyre shkak të fillimit me vonesë është bërë zgjatja tej parashikimeve të seancës pararendëse. Gjithashtu, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë të lartë aftësie në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe

civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara. Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 20 pikë.

“Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore”, “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” dhe “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes”, rezulton që gjyqtarja të jetë treguar korrekte dhe në të dy këto komponentë propozoj që të vlerësohet përkatësisht 5 pikë dhe 10 pikë, sipas treguesve.

Në mënyrë të përmbledhur, propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtarës” është 94 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Kriteri i tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

“Etika në punë”, “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” -

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion, duke e pikëzuar me 35 pikë.

“Integriteti i gjyqtarës”, “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” -

Vlerësoj se shkalla e integritetit të gjyqtarës është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 40 pikë.

“Paanësia e gjyqtarës”, “Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese”,

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese, duke e pikëzuar me 10 pikë.

“Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës”-

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtares. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është i pakonsiderueshëm, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Pra, propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është 100 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Për të kaluar tek kriteri i fundit “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, “Aftësia e komunikimit”, Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit paraqet aftësi shumë të mira komunikimi, komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe gjuha e përdorur është në nivel të mirë. Për këto arsye, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares në këtë tregues të pikëzohet me 25 pikë.

“Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, propozoj edhe këtu vlerësimin me 15 pikë.

“Aftësia për të bashkëpunuar”, “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta”-

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, presumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta. Vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

“Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore”-

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, presumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të

komunikimit dhe bashkëpunimit me ta, e për pasojë vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

“Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, “Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”-

Referuar burimeve të vlerësimit, vërtetimeve të dala nga Shkolla e Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ajo ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrëses.

Konkretisht, gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 17 aktivitete të zhvilluara për 29 ditë, kohëzgjatje e të cilave është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën trevjeçare dhe për këtë arsye vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me 25 pikë (20 pikë).

“Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” -

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtares, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e saj në veprimtari trajnuese si eksperte ose lehtësuese në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e saj për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

“Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e

sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata” -

Në projektraportin e vlerësimit lidhur me këtë treguesin, është propozuar që gjyqtarja të vlerësohet me 3 pikë, në kushtet kur nga burimet e vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja, ka paraqitur kundërshtime duke paraqitur si provë vërtetimin datë 20.12.2022, lëshuar nga drejtuesja e projektit “Për një drejtësi pa vonesa” të zbatuar nga prezenca e OSBE-së në Shqipëri, nëpërmjet të cilit vërtetohet se gjyqtarja {...} gjatë periudhës së implementimit të projektit (2016-2019) është angazhuar për përmirësimin e efikasitetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ku disa prej angazhimeve kanë qenë në pjesëmarrjen në mbledhje me gjyqtarët e seksioneve civile dhe penale për të nxitur administrimin në kohë të çështjeve gjyqësore; nxitjen dhe pjesëmarrjen aktive në takime me drejtuesit dhe prokuroret e prokurorisë për të diskutuar problematika dhe gjetur zgjidhjet përkatëse për të rritur numrin e seanca produktive; zhvillimin e takimeve me komisaritet e policisë në Lezhë me qëllim forcimin e bashkëpunimit sa i takon realizimit me suksese të të pandehurve; takime me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Dhomën Vendore të Avokatisë Tiranë. Për periudhën e vlerësimit 2013-2016 rezulton se në kuadër të këtij projektit të jetë zhvilluar tryeza e rrumbullakët në datën 15.09.2016, ku evidentohet pjesëmarrja e gjyqtarës.

Metodologjia e Pikëzimit për këtë tregues përcakton se do të konsiderohen veprimtari jashtë funksionit, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore [...], pra të gjitha të pasqyruara për mënyrën siç rregullohen nga dispozitë, dhe duke marrë parasysh se pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë. Duke qenë se gjyqtarja nuk ka një angazhim në lidhje me këto veprimtari, por thjesht pjesëmarrje, unë i qëndroj propozimit për vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë.

“Publikimet ligjore akademike” –

Referuar burimeve të vlerësimit, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë publikime akademike si autore ose si bashkautorë. Pra propozimi për nivelin e pikëzimit në lidhje

me këtë tregues është 0 pikë.

Në lidhje me kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, niveli i vlerësimit propozohet të jetë 91 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Në mënyrë të përmbledhur propozimi për nivelin e pikëzimit për çdo kriter vlerësues dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit për gjyqtaren {...} është si më poshtë:

1. Aftësitë profesionale të gjyqtares, niveli i pikëzimit 100, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”;

2. Aftësitë organizative të gjyqtares, niveli i pikëzimit 94, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”;

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, niveli i pikëzimit 100, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”;

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, niveli i pikëzimit 91, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Në vlerësimin e përgjithshëm, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (gradimi), propozoj të jetë niveli i pikëzimit 385 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Faleminderit për vëmendjen!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Ftoj anëtarët e Këshillit nëse kanë diskutime për sa u parashtrua.

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Unë kam një diskutim, duke qenë se nga ana e relatores së çështjes u bë një propozim i ndryshëm nga projektraporti i vlerësimit, bazuar në kundërshtimet e gjyqtares. Nga ana tjetër doja të sillja në vëmendje qëndrimin lidhur me respektimin e afateve ligjore. Për sa i përket respektimit të afateve ligjore, duke qenë se ne në gradim nuk kemi të dhëna statistikore për të gjitha çështjet me afat ligjor gjatë periudhës 2013-2016, për llogaritjen e këtij indikatorit bazohemi vetëm në dosjet e përzgjedhura me short ose dosjet që na vijnë nga organet e rivlerësimit. Në këtë rast kanë qenë 11 çështje dhe në këto 11

çështje, kanë qenë vetëm 2 çështje të cilat sipas ligjit duhet të zbatohet afati ligjor: një çështje ka qenë e kategorisë familjare që gjyqtarja ka zbatuar afatin 48 orë për ta marrë në shqyrtim dhe një çështje tjetër ka qenë çështje kundërshtime e veprimeve përmbartimore. Tani, sipas ligjit të kohës, konstatimi i relatores që kjo çështje duhet të shqyrtohet brenda 20 ditëve nga momenti i regjistrimit është i drejtë, por kjo çështje ka qenë një çështje që ka qenë e regjistruar më parë një gjyqtari tjetër. Gjyqtari i mëparshëm është përjashtuar se ka dhënë dorëheqjen nga shqyrtimi i çështjes dhe gjyqtarja e ka marrë çështjen në shqyrtim pasi kishte kaluar afati 20-ditor nga shqyrtimi. Pra ishte tejkaluar ky afat. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë që gjyqtarja nuk ka pasur detyrimin për ta shqyrtuar edhe ajo brenda afatit 20-ditor.

Çka ndodhur? Gjyqtarja ka marrë masa për të njoftuar personin e tretë në gjykim, pra ka vlerësuar që çështja duhet të shqyrtohet në prani të palëve. Ndërkohë që lidhur me konstatimin e shqyrtimit të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit tej afatit 5-ditor, në vlerësimin tim nuk është i drejtë, për arsye sepse kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të veprimeve përmbartimore nuk përbën sigurim padie dhe ligji i kohës nuk parashikonte afatin 5-ditor të detyrueshëm për të shqyrtuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të veprimeve përmbartimore, çka do të thotë që kërkesa bashkë me padinë mund të shqyrtoheshin brenda afatit 20-ditor. Nëse do të ishte sigurim padie, atëherë do duhej që gjyqtarja të penalizohej edhe tek kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Në vlerësimin tim, duke qenë se dosjen konkrete për të cilën gjyqtarja ka disponuar tej afatit ligjor, ne e kemi pjesë të burimeve të vlerësimit, pra nuk është siç ndodh në vlerësimet e tjera trevjeçare ku ne i diskutojmë në tërësi afatet ligjore dhe nuk i kemi të gjitha dosjet për shqyrtim; duke parë të gjitha veprimet e gjyqtares korrekte, veprimi i parë që e ka shtyrë për të njoftuar ndryshimin e shkakut dhe të objektit të padisë, pastaj ka shqyrtuar kërkesën për pezullim ekzekutimi e ka kaluar në konkluzione dhe ka shpallur vendimin; në vlerësimin tim, pavarësisht se nuk është respektuar afati 20-ditor, gjyqtarja nuk mund të penalizohet me 6 pikë, duke e pikëzuar me 9 pikë nga 15 pikët e mundshme.

Për këtë arsye, unë propozoj që për këtë kriter pikëzimi të jetë maksimal, 15 pikë. Vetëm për këtë tregues. Në reagimet e tjera që pati edhe relatorja dhe në të gjithë relatimin e projektraportit të vlerësimit, jam dakord, duke marrë parasysh edhe qëndrimet që kemi mbajtur në rastet e tjera të gradimit.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Po, zonja Rupa!

Yllka Rupa: Unë parimisht jam dakord me relatimin që bëri zonja Ukperaj në lidhje me këtë kriter. Por në vlerësimin që i kam bërë çështjes, i jam referuar dhe i jam përmbajtur standardit që Komisioni ka mbajtur zakonisht për vlerësime të tilla.

Ilir Rusi: Atëherë, mund ta saktësoni në mënyrë eksplicite rubrikën përkatëse?

Yllka Rupa: Kundërshtimet i referohen kriterit “Respektimi i afateve ligjore” të cilin unë e kam propozuar të vlerësohet me 9 pikë. Pra është rritur me 2 nivele gjyqtarja. Ndërsa zonja Ukperaj propozon nivelin maksimal që është 15 pikë. Në qoftë se Këshilli e vlerëson të arsyetuar dhe të argumentuar, unë jam dakord.

Ilir Rusi: Ka diskutime të tjera?

Marçela Shehu: Kam një diskutim për atë që thotë zonja Rupa, që ju i jeni referuar standardeve që keni mbajtur si Komision. Domethënë, një qëndrim ndryshe na cenon standardin.

Brikena Ukperaj: Atëherë, për ta diskutuar këtë gjë.

Kur vijnë raportet e vlerësimit në Këshill, nuk vijnë nga Komisioni, vijnë nga relatori. Komisioni në të gjitha rastet shqyrton plotësinë e procedurës, sipas ligjit dhe sipas rregullores. Përkundrazi, në raste të tjera kur kemi pasur gradime, vetëm një dosje e

shqyrtuar jashtë afatit nuk e ka penalizuar gjyqtarin. Përmend këtu rastin e zonjës {...}, kur ishin të gjitha çështjet jashtë afatit ligjor, ishte 90%, dhe ne shkuam pothuajse në 12 pikë. Nuk mundet dot për 1 çështje të shkojë në 9 pikë. Marrim rastin e një gjyqtari tjetër të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Gjyqtarja kishte vërtet një çështje sepse përqindja matematikore këtu llogaritet bazuar në dosjet që ne kemi si burime vlerësimi (11 dosje), nuk llogaritet në 1500 vendime që bën gjyqtari. Në rastet kur kemi pasur vlerësimet trevjeçare, kur i kemi afatet ligjore të të gjitha çështjeve, atëherë kemi mbajtur qëndrimin që mund të shkojmë deri në dy nivele ose në një nivel, por jo në pikëzim maksimal. Por kur ke vetëm një çështje në periudhën 2013-2016, e cila sigurisht në dy çështje të shqyrtuara, në qoftë se kalon afatin, qoftë edhe me një ditë, do dalë 50% llogaritja matematikore.

Në këtë rast, duke analizuar edhe veprimet e gjyqtares sipas metodologjisë, të përligjura për mua të gjitha, nuk mund të shkojë thjesht - sepse nuk mund të rrisim 2 nivele apo një nivel - në pikëzim 9 pikë. Në vlerësimin tim, aftësia e gjyqtares duhet të jetë 15 pikë sepse e ka menaxhuar shumë mirë çështjen në drejtim të respektimit të afatit ligjor. Pra nuk kemi standarde të ndryshme në Komision.

Ilir Rusi: Pra zonja Ukperaj, tek seksioni “Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë”, tek nënpika e saj “Respektimi i afateve ligjore”, nga relatorja është 9 pikë, ju e propozoni 15 pikë. Për këtë është fjala.

Marçela Shehu: Mundem?

Ilir Rusi: Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Unë personalisht nuk kisha diçka kundër dhe përgjigjja mund të mos ishte kaq e gjatë, se nuk është se po e kundërshtoja. Meqë relatorja tha që i ishte referuar standardeve, merakun dhe dyshimi im vetëm ky ishte, mos kemi cenim të standardit apo jo?! Nuk është se kisha nevojë për raste konkrete për të treguar që e kemi

bërë kështu tek zonja {...} apo e kemi bërë kështu tek një gjyqtar tjetër. Në qoftë se standardi është njësoj në të gjitha rastet, përgjigja mund të ishte vetëm kaq, që standardi nuk ka ndryshuar.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Shehu!

E ndjeja përgjegjësi, duke qenë se...

Marçela Shehu: Se në fakt pyetja ishte për zonjën Rupa, s' ishte për juve.

Brikena Ukperaj: Pasi të dëgjova ty, unë kam të drejtën që të marr fjalën për të dhënë edhe mendimin tim lidhur me çështjen. Standardi nuk është përgjegjësi vetëm e Komisionit, është përgjegjësi edhe e Këshillit.

Marçela Shehu: Patjetër!

Brikena Ukperaj: Kur miratohen raportet e vlerësimit, miratohen edhe...

Marçela Shehu: Sigurisht që Komisioni i Vlerësimit e ka më të qartë panoramën e standardit.

Brikena Ukperaj: Patjetër! Por Komisioni nuk hyn në punën individuale të relatorit për çdo projektvlerësim. Neve mund të vijmë me mendime të ndryshme këtu. Ka ndodhur.

Marçela Shehu: Gjithsesi unë ta thashë mendimin tim. Unë personalisht jam dakord. Unë kisha pyetje vetëm për atë që tha Yllka, dhe nuk kishte ngarkesë pyetja ime. Ishte pyetje e thjeshtë, pa ngarkesë. Kemi cenim të standardit apo jo? Nuk ka! Jam dakord. Kaq!

Ilir Rusi: Ka diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime të tjera.)

Atëherë, hedhim në votim propozimin e perifrashuar nga zonja Ukperaj.

Irena Plaku: Pro, pasur parasysh edhe standardet. Unë kam vlerësuar dy gjyqtarë (pa përmendur emrat) në gradim dhe njëra nga këto ka pasur mbi 50% dhe njëra ka qenë fiks në këtë situatën e tillë (ka pasur një kundërshtim veprimesh përmbartimore dhe një çështje tjetër), e cila është vlerësuar me pikët maksimale. Sepse vetëm kundërshtimi i veprimeve përmbartimore nuk është marrë... domethënë vetëm një çështje, duke qenë se vlerësimi është bërë vetëm për dy çështje, e kemi propozuar 15 pikë. Janë dy raporte, pa përmendur emrat. Duke qenë se unë kam mbajtur të njëjtin standard, unë personalisht domethënë, siç e kam propozuar, jam dakord për propozimin 15 pikë. Është vetëm për gradimet ky rast.

Dritan Hallunaj: Pikërisht për standardin unë jam kundër. Pra duhet të mbajmë të njëjtin standard që është mbajtur vazhdimisht dhe mos të cedojmë tek kjo pjesë. Faleminderit!

Ridvan Hado: Dakord me propozimin.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë, miratohet propozimi i zonjës Ukperaj.

Në vijim do të ftoja relatoren për të bërë reflektimet përkatëse me qëllim që të hedhim në votim projekt-aktin duke integruar edhe miratimin e propozimit të bërë nga zonja Ukperaj.

Yllka Rupa: Atëherë, vlerësimi i përgjithshëm për gjyqtaren {...}:

1. Aftësitë profesionale të gjyqtares, 100 pikë, niveli i vlerësimit

“Shkëlqyeshëm”; 2. Aftësitë organizative të gjyqtares, 100 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”; 3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”; 4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, 91 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”. Në tërësi niveli i pikëzimit për gjyqtaren 391 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Atëherë, pas reflektimit të miratimit të propozimit të zonjës Ukperaj, prezantuar së fundi nga relatorja përkatëse, ftoj anëtarët për votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Pjesërisht dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pjesërisht dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe

është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.03.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017-2019”, relatore znj. Irena Plaku.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 15:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami* si dhe anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Rezarta Taushani dhe Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Të tjerë: Edmond Hoxhaj (BIRN).*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017-2019, relatore *znj. Irena Plaku*.

Ilir Rusi: Në vijim, vazhdojmë me pikën dy të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017-2019.

Për më tej, fjala relatores *znj. Plaku*.

Irena Plaku: Faleminderit!

Po ju paraqes në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017-2019.

Siç jeni njohur paraprakisht, gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime të cilat janë njoftuar nëpërmjet e-mailit të gjithë anëtarëve. Gjithsesi do t'i vë në dukje edhe sa herë të ketë kundërshtime referuar faktit se shumica e kundërshtimeve i përket kriterit të parë të

vlerësimit.

Jeni njoftuar rregullisht edhe për raportin analitik të hartuar nga nëpunësja përgjegjëse.

Procedura për vlerësimin etik të gjyqtarës {...} ka filluar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 177, datë 29.04.2021. Janë kryer të gjitha procedurat për hedhjen në short; janë administruar aktet nga të gjitha institucionet, për të cilët Këshilli ka detyrim që t'i administrojë në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional.

Gjithashtu gjyqtarja është njoftuar për projektraportin rregullisht dhe ka paraqitur kundërshtime brenda afatit të parashikuar.

Me vendimin e datës 17.11.2022 është vendosur plotësia e procedurës dhe e dokumentacionit të dosjes.

Po filloj me analizimin e kriterit të parë, konkretisht me “Aftësinë profesionale të gjyqtarit”, njohuritë e saj ligjore, “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm ose konfliktin e normave”, në tërësi është referuar që gjyqtarja, duke qenë se për këtë kriter nuk konstatohet që të ketë kundërshtime, përveçse është bërë një konstatim lidhur me faktin se është pasqyruar në projektraport se tek një vendim i pushimit është shkruajtur që nuk janë pasqyruar rrethanat e faktit. Kjo është e vërtetë në fakt, por i gjithë pasqyrimi i dosjeve është pasqyruar në kuadër se çfarë përmbajnë aktet e dosjes pa i vënë theksin në rast se duhet apo nuk duhet pasqyruar. Thjesht janë pasqyruar ato që kanë pasur vendimet të administruar, duke mos e penalizuar në fakt sepse normalisht dihet që në vendimin e pushimit nuk pasqyrohen rrethanat dhe faktet por është thjesht procedura e ndjekur. Thashë që është pasqyruar vetëm për të identifikuar vendimet të cilat janë pasqyruar dhe janë administruar në kuadër të vlerësimit.

Atëherë, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për përshkrimin dhe analizën e fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecures së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen në trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë koncize, të plotë dhe analitike, duke

integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor. Gjithashtu gjyqtarja ka aftësi të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e saj.

Për nëntreguesin e parë është propozuar aftësia e gjyqtarës si shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Lidhur me “Aftësinë për të interpretuar ligjin”, për të cilin gjithashtu gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime. Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (procedurale dhe materiale - civile apo penale) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore në shumicën e rasteve referohen ose citohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre abstrakt dhe por e njëjta rëndësi nuk i kushtohet interpretimit të tyre me aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Nga burimet e vlerësimit konstatohet se përgjithësisht gjyqtarja përqendrohet në interpretimin abstrakt të normës, të shoqëruar në shumë raste edhe me praktikën e Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe në disa raste edhe të GJEDNJ, duke dhënë një panoramë të gjerë të praktikës lidhur me çështjet e ngjashme, pa e zërthyer normën në raport me faktet e çështjes, për të shkuar si rrjedhojë logjike në konkluzionet e arritura lidhur me zbatimin e saj në rastet konkrete apo në rastet kur bëhet një zberthim i tillë është i shkurtër në raport me trajtimin teorik të rastit.

Më poshtë vijon me citimin e dispozitave të cilat janë arsyetuar nga ana e gjyqtarës, konkretisht nenet e Kodit të Familjes në çështjet familjare, nenet 608, 609, 614 të K.Civil, duke analizuar elementët e dëmit me karakter pasuror, duke konkluduar në nevojën e ekzistencës së katër elementëve që një person të mbajë përgjegjësi; nenin 772, të K.Civil duke analizuar kontratën e furnizimit; në çështjen me objekt kundërshtimin e vendimit të AKKP, gjyqtarja ka identifikuar dhe cituar si ligj të zbatueshëm, ligjin

nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe Kompensimin e pronës” i ndryshuar, dhe ligjin nr.133/2015, si dhe ka identifikuar qëllim dhe funksionin e tij, kushtet dhe kriterit që duhet të plotësohen në mënyrë komulative, që gjejnë zbatim në rastin e shqyrtimit të vendimeve të AKKP-së apo KKP-së si vendime që njohin të drejtën e pronësisë së subjekteve të shpronësuar, duke dhënë një panoramë të gjerë të qëndrimeve të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese apo të GJEDNJ, lidhur me çështjet që i përkasin vendimeve të AKKP-së, por pa cituar dhe analizuar dispozitat konkrete të ligjeve “Për kthimin e kompensimin e pronave”, të ndryshuar ndër vite, të cilat gjejnë zbatim në rastin konkret, apo për të analizuar pse vendimi i AKKP-së objekt ankimi është marrë në kundërshtim me ligjin, në raport me rrethanat dhe faktet e çështjes të provuara.

Përveç dispozitave të Kodit të Familjes, ka analizuar nenin 53 të Kushtetutës, nenin 8 të KEDNJ, ligjin “Për masat ndaj dhunës në familje” në çështje që ka qenë me objekt për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes; nenin 42 të Kushtetutës. Në vendimet penale janë cituar një sërë dispozitash (pa i përmendur të gjitha), si dhe dispozita të ligjit të posaçëm kur ato kanë gjetur zbatim në rastet konkrete. Gjithashtu konstatohet se përgjithësisht gjyqtarja identifikon dhe përdor gjerësisht jurisprudencën relevante të vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë (të kolegjeve të civile dhe penale), të Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, në mbështetje të argumenteve të saj, ku janë cituar në shumicën e vendimeve ku ajo ka cituar dhe marrë në shqyrtim domethënë ka referuar praktinë unifikuese. Gjithashtu është konstatuar që në vendimet burim vlerësimi, citon dhe analizon në kontekst të arsyetimit të vendimit dhe parimet e përgjithshme të së drejtës.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi të mira në interpretimin e ligjit procedural në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes, por jo gjithmonë shfaq të njëjtën aftësi në interpretimin e ligjit material, sidomos në çështjet civile, në funksion të vlerësimit të çështjeve që shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Dispozitat e ligjit material përgjithësisht rezultojnë të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i

zberthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës, por nuk i kushtohet e njëjta rëndësi aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës.

Pas analizimit të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit vlerësoj se aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” është mbi mesatare, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Siç e theksova më sipër, gjyqtarja ka paraqitur kundërshtimet e saj lidhur me projektraportin që në fakt është cituar “kundërshtime në lidhje me projektraportin”, por thjesht është një atakim personal i imi, duke më treguar aftësitë apo si duhet të interpretoj ligjin, domethënë duke atakuar në fakt vlerësuesin.

Gjithsesi, po parashtroj, duke qenë se nuk është se janë të specifikuar për secilin kriter, por duke qenë se për kriter gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime, po e citoj në mënyrë të përmbledhur.

Fillimisht ka parashtruar se: Projektraporti nuk pasqyron aspak punën, angazhimin, lodhjen dhe përkushtimin në detyrë. I kam kushtuar rëndësi dhe vëmendje çdo çështje, arsyetimit të çdo vendimi, vëmendje të theksuar dhe kur lexoj projektraportin kuptoj që ndoshta kam vepruar gabim. Kam qëndruar në punë çdo ditë në orët e vona. Bëj me dije që çdo javë kam patur minimumi 40 vendime, etj.

Siç e theksova është bërë edhe një gabim tek datëlindja e magjstrates.

Së dyti ka theksuar, është cituar një vendim konkretisht që është vendosur pushimi i gjykimit dhe nuk është paraqitur rrethanat dhe faktet.

Siç e sqarova në fakt është thjesht një pasqyrim i të gjitha çfarë ka rezultuar nga secili burim vlerësimi (vendimi), vendime të administruara, siç janë relatuar dhe pasqyruar edhe në projektraportin analitik të hartuar nga nëpunësja përgjegjëse.

Në faqen 9 të projektraportit është cituar se vendimi i përzgjedhur prej meje, vendimi 52, datë 07.02.2018 kam cituar si ligj të zbatueshëm, ligjin Nr.9253/2004, por

nuk kam cituar dispozitat konkrete që gjejnë zbatim në rastin konkret. Në lidhje me këtë rast të pretenduar nga ana e relatores, parashtroj se kam çmuar se është e panevojshme të citoj të gjitha dispozitat e ligjit të posaçëm. Kam arritur në këtë konkluzion duke qenë se çështja objekt gjykimi i referohej kryesisht ligjit të posaçëm në tërësi dhe nuk e kam vlerësuar të domosdoshme e të nevojshme të hedh veçmas secilën prej dispozitave konkrete. Gjithashtu, theksoj se kjo ka ndodhur edhe për shkak se vendimmarrja përfundimtare dhe arsyetimi kryesisht është lidhur me aspekte procedurale dhe nuk lidhet me dispozita specifike.

Në fakt, siç e kam theksuar, unë kam pasqyruar atë çka ka rezultuar nga secili vendim gjyqësor dhe në këtë vendim gjyqësor janë pasqyruar dy ligjet përkatëse, konkretisht i vitit 2004 dhe i 2015, megjithëse janë periudha të ndryshme dhe kanë objekte të ndryshme, domethënë pavarësisht se objekti lidhet vetëm me vendimet e komisioneve por janë të ndryshme ndërmjet tyre, nuk është bërë asnjë arsyetim mbi asnjë dispozitë të këtij ligji. Edhe për sa i përket vendimmarrjes që thotë është kryesisht në aspektin procedural, në përfundim ka vendosur pranimin duke njohur edhe të drejtën e pronësisë njëzërisht prej palëve. Më pas ka shkruajtur të gjithë arsyetimin e vendimit ashtu siç ka qenë tek vendimi gjyqësor.

(citohet) Së katërti, relatorja parashtron se përgjithësisht identifikoj dhe/ose citoj dispozitat materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes dhe në vijim liston vendimet, duke cituar edhe dispozitat përkatëse që unë kam identifikuar për secilin rast. Në asnjë moment nuk rezulton të mos kem identifikuar dispozitat materiale dhe pavarësisht këtij fakti relatorja ka arritur në konkluzionin se unë përgjithësisht, pra jo në çdo rast, identifikoj.

Atëherë, siç u relatua më sipër, unë kam pasqyruar çdo... domethënë është pasqyruar si në projektraportin e vlerësimit ashtu edhe në raportin analitik, çdo dispozitë e cila është cituar nga ana e gjyqtarës dhe për treguesin e parë nuk i është ulur asnjë pikë, duke e pikëzuar me nivelin maksimal, por tek pjesa e analizës ligjore, që është vlerësuar “mbi mesataren”, kam konkluduar që duhet të vlerësohet “mbi mesataren” pasi i kushton tepër rëndësi arsyetimit abstrakt të dispozitave ligjore, pa iu përkushtuar arsyetimit ligjor

në lidhje me faktet e çështjes konkrete. Kjo rëndësi nuk i kushtohet sidomos tek çështjet civile, se ndërsa tek çështjet penale i ka kushtuar më shumë rëndësi këtij aspekti. Nga ana e relatores nuk vlerësohet në fakt e gjithë puna trevjeçare e saj sepse vlerëson në bazë të statistikave të cilat janë marrë parasysh, por merren parasysh vetëm burimet e vlerësimit të cilat janë administruar në kuadër të procedurës së vlerësimit.

(citohet) Së pesti, është konkluduar se në vendimin nr.220, datë 07.04.2017 nuk kam arsyetuar kur fillon të llogaritet afati i parashkrimit, kur quhet i ndërprerë. Nuk është dakord me këtë konkluzion, duke qenë se në vendim kam arsyetuar se: padia është parashkruar. (Domethënë ka cituar përsëri pjesën e vendimmarrjes së saj). Pra, siç rezulton më sipër unë kam arsyetuar në lidhje me rastin që kam patur për gjykim dhe kam arsyetuar se kur ka filluar ndërprerja e parashkrimit. Nuk kam patur asnjë arsye për të arsyetuar për rastet se kur parashkrimi nuk quhet i ndërprerë, duke qenë se nuk ka qenë rasti për të bërë teori në lidhje me të gjithë institutin e parashkrimit të padisë. Bëj me dije se ky ka qenë një nga prapësimet e palës së paditur dhe nga ana e kësaj pale është prapësuar vetëm se padia është parashkruar, pa e trajtuar më tej këtë prapësim. Ndërkohë, që unë në vendim kam arsyetuar përse nuk qëndron ky prapësim, por nuk kam patur asnjë arsye për të bërë një trajtim më të detajuar të institutit të parashkrimit. Gjithashtu, relatorja nuk ka argumentuar se përse unë duhet të kisha arsyetuar se kur fillon të llogaritet afati.

Në fakt, në këtë vendim, siç u theksua më sipër, përgjithësisht gjyqtarja i kushton tepër rëndësi arsyetimit abstrakt të secilës dispozitë ligjore, dhe tek zbatimi nuk i kishte kushtuar gjithmonë të njëjtën rëndësi. Ndërsa në disa raste, siç është ky rast, nuk i ka kushtuar rëndësinë e duhur arsyetimit të dispozitave, të cilën e bën përgjithësisht, por jo në të gjitha rastet dhe mënyrë e arsyetimit e kësaj vendimmarrjeje përsëri nuk e tregonte të qartë atë çfarë ka vendosur ose si ka arsyetuar gjykata. Në fakt në rastet e pretendimit për parashkrimin e padisë gjykata e ka detyrimin të analizojë çdo pretendim lidhur me parashkrimin e padisë sepse lidhet me shqyrtimin në themel ose jo të çështjes dhe e cila mund të paraqitet edhe me prapësim dhe nuk ka nevojë që të paraqitet si padi.

(citohet) “Së gjashti, relatorja ka arritur në konkluzionin se aftësia ime për të

interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes nuk është e lartë, por është mbi mesataren”. Dhe ka cituar më pas konkluzionet e arritura prej meje të cilat u relatuan.

(citohet) “Duke iu referuar vendimeve civile, për të cilat konkludohet se interpretimi i ligjit material nuk është në nivelin e duhur, vlerësoj se ky konkluzion nuk është në koherence me atë çka vetë vlerësuesi ka konstatuar në pjesën përshkruese të këtij treguesi. Konkretisht, në vendimet për çështjet familjare...” – magjistratja është marrë me këtë vendim tek çështjet familjare, të cilën unë e kam analizuar në mënyrë të detajuar atë çfarë gjyqtarja ka arritur në këtë konkluzion. Siç e thashë më sipër, konkluzioni nuk arrihet vetëm me një vendimmarrje por në tërësi të gjitha vendimmarrjet të cilat janë administruar në kuadër të procedurës së vlerësimit.

(citohet) Në vijim relatorja rendit vendimet objekt vlerësimi, duke mos gjetur ndonjë problematikë në pjesën më të madhe të tyre.

Ka cituar vendimmarrjet dhe konkluzionet të cilat janë arritur nga ana imë në projektraport.

(citohet) Konstatohet se i gjithi ky konkluzion është mbështetur tek dy vendime, që janë cituar edhe më sipër.

Domethënë unë ia kam identifikuar në fakt, megjithëse më poshtë thuhet që nuk janë identifikuar rastet. Por në fakt janë identifikuar në projektraport të gjitha vendimet e gjyqtarës dhe janë analizuar secili prej këtyre burim vlerësimi, ashtu siç janë pasqyruar në raportin analitik, por në projektraport janë analizuar secila prej tyre.

Ka paraqitur kundërshtime në lidhje me: (citohet) Vendimi nr. 222, datë 07.04.2017, relatorja gjen si shkelje faktin se unë nuk kam cituar përmbajtjen e plotë të neneve”. Në fakt në projekt-akt kam gjetur si shkelje por kam arsyetuar referuar burimeve të vlerësimit pse arsyetimi ligjor nuk është shumë i lartë por është mbi mesataren.

Më pas ka analizuar përsëri në lidhje me vendimin nr. 52 : (citohet) nga relatorja parashtrohet se është identifikuar qëllimi i ligjit të zbatueshëm, funksionet e tij, kushtet dhe kriteret ligjore që duhet të ekzistojnë në rastrin e shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimeve të AKKP apo KKP, duke referuar edhe një serë qëndrimesh të Gjykatës së

Lartë, Gjykatës Kushtetuese lidhur me legjislacionin e zbatueshëm në këtë fushë, por nuk kam cituar dispozitat konkrete të ligjit të posaçëm që gjejnë zbatim në rastin konkret apo për të analizuar se përse vendimi i AKKP objekt ankimi është marrë në kundërshtim me ligjin. E kundërshtoj këtë konkluzion dhe nuk jam dakord, duke iu referuar ngushtësisht burimit të vlerësimit (vendimit gjyqësor) të referuar si dhe vetë konstatimeve të bëra në projektraport më rezulton se ky përfundim nuk është i mbështetur. Siç kam cituar edhe më sipër kam çmuar se është e panevojshme të citoj të gjitha dispozitat e ligjit të posaçëm. Kam arritur në këtë konkluzion duke qenë se çështja objekt gjykimi i referohej kryesisht ligjit të posaçëm në tërësi dhe nuk e kam vlerësuar të domosdoshme e të nevojshme të hedh veçmas secilën prej dispozitave konkrete të ligjit të posaçëm. Theksoj se kjo ka ndodhur edhe për shkak se vendimmarrja përfundimtare dhe arsyetimi kryesisht është lidhur me aspekte procedurale. Në vendim qartësisht është referuar kuadri ligjor i zbatueshëm, duke u interpretuar në funksion të identifikimit të qëllimit dhe funksionit të tij si dhe duke zbërthyer normat që lidhen me identifikimin e elementeve kumulative lidhur me vlerësimin ligjshmërisë së vendimeve të KKP, sikurse vetë relatorja konkludon. Mospitimi i dispozitave në çdo rast, sikurse konstatohet, vlerësoj se nuk cenon cilësinë e vendimit pasi gjithë kuadri ligjor i zbatueshëm në rastin konkret referohet dhe analizohet, edhe pse në vlerësimin tim teksti i vendimit nuk ngarkohet me citim të dispozitave, të cilat shërbejnë kuadrin ligjor të njohur dhe jo në çdo rast është e nevojshme të citohet, duke ngarkuar përmbajtjen e vendimit. Më rezulton duke iu referuar burimit konkret të vlerësimit për këtë rast se kuadri ligjor është referuar i plotë, dhe interpretuar në mënyrë të qartë dhe të plotë, para aplikimit mbi faktet e çështjes, dhe në unitet të plotë me konkluzionin e arritur për zgjidhjen e çështjes. Gjithashtu, nëse do ishte lexuar me vëmendje dhe me qëllim për të kuptuar vendimmarrjen time, do rezultonte se në fakt e kam arsyetuar qartë shkakun se përse ky vendim duhej anuluar (duke përmendur shprehimisht vendimin e Gjykatës Kushtetuese, ku janë cituar edhe nenet konkretet të ligjit të posaçëm) si dhe ashtu siç është cituar edhe më sipër (pika tre), vendimmarrja përfundimtare dhe arsyetimi kryesisht është lidhur me aspekte procedurale të ligjit. Nuk është marrë në analizë në aspektin material vendimi i AKKP sepse nuk ka

qenë nevoja në rastin konkret.

Gjyqtarja thotë që nuk citon ligje sepse nuk e ka të nevojshme, konkretisht ligjet materiale të cilat zbatohen, në fakt gjyqtarja në këtë vendim ka cituar edhe vendime të Gjykatës Kushtetuese edhe nenet të GJEDNJ-së edhe dispozita të Kushtetutës, por të ligjit të posaçëm nuk janë referuar dhe këtë e kam pasqyruar në fakt, që janë analizuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, praktika e mbajtur, dhe mbi bazën e këtyre praktikave është arritur në një konkluzion mbi qëllimin e ligjit. Por, duke iu referuar rastit konkret nuk ka asnjë citim për ligjin e zbatueshëm dhe dispozitat konkrete që gjejnë zbatim në rastin konkret të këtij ligji, meqenëse është ligj material dhe mbi bazën e të cilit, meqenëse padia ka të bëjë me padinë “njohje pronar”, në bazë të vendimit të AKKP-së, nuk është arsyetuar megjithëse rezulton se janë administruar një sërë provash në këtë kuadër.

(citohet) Në vijim të mbrojtjes së mësipërme, dua të shtoj se nga relatorja nuk është marrë në konsideratë në asnjë moment fakti që për 19 vendime objekt vlerësimi, pavarësisht leximit “objektiv” nuk është konstatuar asgjë që mund të ishte identifikuar në vlerësimin tim. Nuk është marrë në konsideratë fakti se për periudhën e vlerësimit kam shpallur dhe arsyetuar 2334 vendime e për asnjë nga këto vendime nuk kam patur qoftë një kërkesë të vetme për interpretim; nuk është cenuar asnjë vendim për mosinterpretim të ligjit në zgjidhjen e çështjes apo të jetë cituar si mangësi në vendimin e një gjykate më të lartë; nuk është pretenduar nga asnjë palë si shkak ankimi diçka e tillë. Konstatoj se në rastin tim i gjithë vlerësimi është bazuar në dy vendime (ku njëri është zgjedhur dhe paraqitur nga vetë unë, duke qenë se është vlerësuar si një vendim që përmbush të gjitha kriteret për të qenë një vendim i arsyetuar) dhe relatorja çuditërisht bazuar në këto dy vendime (ku edhe konkluzionet në lidhje me këto vendime siç kam argumentuar më sipër nuk qëndrojnë) ka arritur në një konkluzion aspak të drejtë. Nga ana e relatores nuk është gjetur asnjë problematikë në vendimet për çështjet familjare, penale themeli/seancë paraprake/kërkesa penale, civile të tjera (ku duhet të citohet se janë 12 çështje civile objekt vlerësimi). Gjithashtu, duhet të theksoj se nga ana e relatores nuk është argumentuar aspak konkluzioni i arritur, duke më bërë të vështirë edhe kundërshtimin e

konkluzionit të saj. Nuk e kuptoj se si mund të anashkalohet e gjitha puna e bërë nga ana ime dhe mbi të gjitha është e paqartë se si relatorja ka vlerësuar gjyqtarët e tjerë shkëlqyeshëm në këtë rubrikë. A është e mundur që çdo gjyqtar tjetër që është vlerësuar prej saj të ketë qenë perfekt në aftësitë profesionale në çdo vendim objekt vlerësimi? Sa më sipër, në vlerësimin tim, burimet e vlerësimit në të cilat janë konstatuar “mangësi” lidhur me këtë tregues, në përmbajtjen e tyre tregojnë të kundërtën e konkluzionit të arritur dhe si rrjedhojë vlerësoj se për këtë tregues shkalla e aftësisë duhet të vlerësohet “shumë e lartë”, duke iu referuar burimeve të vlerësimit në tërësi si dhe elementeve përbërës që shërbejnë për vlerësimin e këtij treguesi në tërësi.

Në fakt gjyqtarja këtu ka hedhur aludime se si janë vlerësuar gjyqtarët e tjerë, por nuk ka paraqitur asnjë raport apo pretendim se ku e bazon, pse gjyqtarët duhet të jenë të njëjtë në radhë të parë, tek se si vlerësohen. Puna e saj për sa i përket 2334 vendimeve është vlerësuar tek kriteri i dytë “Aftësitë organizative” të saj, ku ndër të tjera, nga ana ime është vlerësuar maksimalisht me 100 pikë, duke konkluduar se i ka respektuar të gjitha, domethënë ka qenë shumë e rregullt në zhvillimin e procedurës.

Për sa i përket kriterit të parë, kriteri i parë vlerësohet vetëm mbi burimet e vlerësimit, vendime të cilat janë administruar, të zgjedhura prej saj dhe të hedhura në short sipas rregullave të miratuara nga Këshilli. Referuar këtyre burimeve të vlerësimit është arritur një konkluzion i tillë që për këtë aspekt është vlerësuar se aftësia e saj nuk është shumë e lartë, por është mbi mesataren dhe për mua është një vlerësim më se i drejtë.

Së shtati, relatorja ka arritur në konkluzionin se aftësia ime në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”... Kjo ka të bëjë me treguesin tjetër.

Gjithsesi unë po vijoj me kriterin tjetër, me treguesin tjetër, dhe më pas do citoj edhe kundërshtimet e saj lidhur me këtë tregues.

Sa i përket “Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit”, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjyqimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e

drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara (në thonjëza), duke u shoqëruar me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse, pa krijuar konfuzion për përmbajtjen apo kuptimin e tyre. Në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit apo në kuadër të referimit të ligjeve të posaçme, përdorimi i termave teknikë është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose kuptohet qartë nga konteksti i arsyetimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Në vendimet gjyqësore për çështjet familjare evidentohet kujdesi i gjyqtarës për zgjedhjen e gjuhës së përdorur, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre nga palët, në respektim të parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe të drejtës për jetë private dhe familjare të subjekteve të procedimit.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip. Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe në disa raste edhe fjali më të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik, por kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës. Vendimet në përgjithësi janë të organizuar në nënndarje, të identifikuara në shumicën e vendimeve me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, të cilët

lidhen me njëri-tjetrin në mënyrë kronologjike dhe vazhdimësisë së mendimit. Karakteristike e gjyqtarës është përmbyllja e arsytimit në secilin paragraf apo pjesë të vendimit më një ose disa fjali përmbyllëse, që vijnë si rrjedhë logjike e mendimit të shprehur dhe përbëjnë konkluzionin e arritur.

Në disa nga vendimet e analizuar evidentohet vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme, por duke vijuar në pjesën e argumentimit ligjor me zbërthimin dhe analizën e tyre por kjo nuk cenon koncizitetin e vendimit dhe duket së është përdorur gjithnjë me qëllim analizën e dispozitave në pjesën vijuese të arsytimit.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Pas analizimit të të dhënave vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

“Struktura e qëndrueshme e vendimit”, nga analizimi i burimeve për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar nga pikëpamja formale, të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale apo të themelit të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, argumentimin ligjor dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Këto të fundit vijnë gjithnjë si mbyllje e procesit të arsytimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtarja ndjek përgjithësisht një metodologji të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuar me tituj, në funksion të orientimit mbi qëllimin e secilës pjesë, por këto pjesë në shumicën e rasteve nuk janë ndarë në paragrafë, të cilat do ta lehtësonin të kuptuarit e vendimit. Në pjesën më të madhe të vendimeve, arsytimi paraqitet si një i tërë (pa paragrafë), sidomos tek pjesa që gjejnë pasqyrim rrethanat e faktet dhe pretendimet e palëve, të cilat e bëjnë jo gjithmonë të lehtë kuptimin. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën

hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit. Pjesa përshkruese është e ndarë në procedura ku është ndalur gjerësisht gjyqtarja, rrethanat e faktit së bashku me përshkrimin dhe analizën e provave të lejuara dhe administruara në gjykim, të analizuara në raport me njëra tjetrën, duke konkluduar për faktin e provuar si deduksion i analizës së provave.

Ligji i zbatueshëm. Në shumicën e vendimeve burim vlerësimi, ligji i zbatueshëm, si ai më natyrë procedurale ashtu edhe dispozitat e ligjit material të zbatueshëm, janë pjesë e integruar e analizës ligjore të gjykatës, duke u lokalizuar krahas argumenteve të gjykatës lidhur me elementë të zbatimit të tij. Thuajse në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi, ligji i zbatueshëm evidentohet nëpërmjet listimit dhe citimit të përmbajtjes së dispozitave, në një nënndarje të veçantë, para analizës ligjore të çështjes. Por në disa vendime, mungon evidentimi i qartë dhe i plotë i ligjit të zbatueshëm, siç u theksua edhe më lart.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me çështjen. Pas evidentimit dhe analizës së elementëve procedurale, fakteve të çështjes dhe referimit të ligjit të zbatueshëm, arsyetimi vijon me nënndarjen “vlerësimi i gjykatës”, në të cilin, sipas kategorisë së vendimeve gjyqtarja zhvillon analizën ligjore të çështjes. Kjo analizë, referuar kompleksitetit të çështjes është e organizuar në disa rasteve në nënndarje, ku merren në analizë secili nga kërkimet e objektit të padisë, apo analizën lidhur me përgjegjësinë penale për secilin të pandehur. Por edhe në këtë pjesë në disa raste konstatohet se mendimi juridik nuk është i ndarë në paragrafë, që të mundësojë një kuptim të qartë të analizës juridike, apo në disa raste kur është ndarë, paraqitet në paragrafë të gjatë (që mund të shkojnë deri në 2-3 faqe).

Gjyqtarja e ka organizuar një pjesë të vendimit duke analizuar fillimisht elementët e figurës së veprës penale për secilin të pandehur duke vijuar me pas me analizimin ligjore në drejtim të caktimit dhe individualizimit të dënimit. Më pas është përshkruar edhe çfarë paraqitet tek dispozitivi i vendimit.

Siç u arsyetua më lart, gjyqtarja ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, kjo sikundër është cituar edhe më sipër, duke i ndarë vendimet në pjesë, ku

gjqtarja zbaton rregullat e shkrimit ligjor, duke identifikuar faktet, provat, argumentin ligjor në lidhje me faktet, ligjin e zbatueshëm, analizën juridike dhe konkluzionin e arritur.

Megjithatë titujt e nënndarjeve të vendimit gjyqësor (procedura, rrethanat e faktit, ligji i zbatueshëm, vlerësimi i gjykatës) nuk janë të vetme mjete të mjaftueshme për organizimin e argumentit logjik. Janë paragrafët ata që e organizojnë shkrimin sipas ideve dhe lehtësojnë të kuptuarit e mendimit, duke e ndarë të në njësi më të thjeshta, paragrafë të cilat duhen renditur në atë mënyrë që mendimi të vijë rrjedhshëm, njëri pas tjetrit.

Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi mbi mesataren në ndjekjen e një strukture të organizuar të vendimit, të ndarë në tituj, por jo gjithmonë mendimi është ndarë në paragrafë, duke u paraqitur çdo pjesë e vendimit si një i tërë. Gjyqtarja ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuara kryesisht nga gjykata, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të cilat janë pjesë e rrethanave të faktit, ndonjëherë të pandarë në paragrafë, ligjin e zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata. Në përgjithësi konstatohet që për çdo nënndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës dhe fjali tematike, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit si dhe në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij duke mundësuar përgjithësisht lexim të organizuar dhe të strukturuar në rrjedhë logjike.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se aftësia e gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, është “ mbi mesatare”, duke e pikëzuar me 8 pikë.

Po lexoj kundërshtimet e gjyqtarës.

Së shtati, thotë gjyqtarja, relatorja ka arritur në konkluzionin se aftësia ime në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar” nuk është e lartë por është

mbi mesataren, - dhe ka cituar konkluzionin që është arritur nga ana ime, siç u citua më sipër).

(citohet) Nuk jam dakord me këtë konkluzion, duke qenë se çdo vendim i imi (me përjashtim të vendimeve civile apo penale jopërfundimtare) është i ndarë në pjesë të veçanta: procedura, faktet dhe pretendimet e palëve, ligji i zbatueshëm dhe vlerësimi i gjykatës. Nuk e bën të pakuptueshëm një vendim mosndarja në paragrafë të shumtë. Ndarja e vendimit gjyqësor në paragrafë, pavarësisht nëse këto paragrafë nga pikëpamja vizuale janë të numërtuar apo të ndarë me hapësira, është evidente, dhe konfigurohet qartë në fillimin e fjalisë së re, në kryeradhë, pavarësisht nëse unë kam përdorur nga pikëpamja teknike hapësirën nga njëri paragraf tek tjetri.

Në fakt unë nuk kam konstatuar as në paragrafë por vendimi vinte si një i tërë, duke vijuar pretendimet e palëve, përshkrimin e rrethanave, vazhonte në rresht përsëri, duke pasqyruar edhe pretendimet e palëve.

(citohet) Më rezulton se ndarja e arsytimit në paragrafë, e cila është e pashmangshme sa herë që përfundon një argument dhe fillon një i dytë, në vijim të tij, dhe është evidente në vendimet gjyqësore, por në rastin tim është përdorur kalimi në fjali të re (kryeradhë) dhe jo në çdo rast hapësira në shkrim. Kjo mënyrë të shkruari, e evidentuar si mangësi në projektraport, vlerësoj se nuk ka asnjë ndikim në strukturën e mirëorganizuar dhe të qëndrueshme të vendimit gjyqësor, e cila konsiston në aspektin logjik të organizimit të mendimit dhe jo thjesht në detaje vizuale, të cilat secili gjyqtar i përdor në mënyrën e tij. Vlerësoj se elementet “teknike” dhe “vizuale” të shkrimit të një teksti, nuk mund të përbejnë element thelbësor që dikton cilësinë e logjikës së organizmit të tij, për sa kohë që nuk ka një rregull të përgjithshëm për aspektin vizual të shkrimit të një vendimi gjyqësor. E njëjta logjike do të na çonte në konkluzione të gabuara edhe nëse një gjyqtar p.sh. përdor një lloj shkrimi në raport me një tjetër. Në këtë drejtim theksoj se kuptueshmëria e vendimit gjyqësor, në këndvështrimin e strukturës së tij, pavarësisht aspektit vizual të tij, qëndron në strukturimin e mendimit logjik dhe jo thjesht në terma teknike të cilat i japin vendimit një “dukje të caktuar”. Pretendohet se vendimet janë të paqarta për shkak se arsytimi paraqitet si një i tërë (pa paragrafë), sidomos tek pjesa që

gjejnë pasqyrim rrethanat e faktit dhe pretendimet e palëve, ndërkohë që unë që në hyrje të kësaj pjese citoj që aty janë përshkruar faktet dhe pretendimet e palëve. Bëj me dije që një gjë e tillë (përfshirja në të njëjtën pjesë e rrethanave të faktit dhe pretendimeve të palëve) ndodh për shkak se pretendimet e palëve shpesh janë të patrajuara dhe të përgjithshme, duke kërkuar thjesht pranim ose rrëzim padie/kërkese; deklarinim ose jo fajtor. Si rrjedhojë, në disa raste nuk e kam vlerësuar të nevojshme që këto pretendime të trajtohen në një pjesë të veçantë dhe që do sillte si pasojë që paragrafët.

Nuk qëndron konkluzioni i relatores se në vendimet penale të themelit vendimmarrjet e ndërmjetme, si p.sh. vendimi për gjykim të shkurtuar pasqyrohen në pjesën “rrethanat e faktit”. Nuk ka ndodhur një gjë e tillë. Nuk e di se ku e ka bazuar këtë konkluzion relatorja, ndoshta kjo pjesë ka ngelur nga ndonjë projektraport i ndonjë gjyqtari tjetër. Lidhur me analizën e zgjeruar në disa raste të elementëve procedurale, vlerësoj se nuk përputhet me ato çka përmbajnë vendimet gjyqësore burim vlerësimi. Kjo pasi pasqyrimi dhe analiza e zgjeruar ligjore lidhur me elementë procedurale është bërë, sikurse evidentohet edhe në raport, vetëm në ato raste kur ka të bëjë me vendimmarrje të ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit, të cilat jo vetëm duhet të arsyetohen në momentin e marrjes së tyre (në gjykim) por në vlerësimin tim duket të jenë pjesë e vendimit gjyqësor përfundimtar, në mënyrë që ai të japë një panoramë të qartë të asaj çka ka ndodhur... [...].

Në fakt është goxha e gjatë kundërshtimi i gjyqtarës në lidhje me këtë tregues.

(citet) Nuk qëndron konkluzioni i relatores se në çështjet civile, përveç tre rasteve, nuk rezulton të ketë një ndarje të arsyetimit për elementët procedural. Në çdo vendim civil ekziston pjesa që titullohet “procedura”.

Nuk qëndron konkluzioni i relatores se nuk arrij të ndaj/strukturoj përshkrimin e fakteve të çështjes si dhe mendimin tim juridik në analizimin e çështjes në paragrafë, duke e bërë vendimin jo thjesht të kuptueshëm. Fillimisht dua të parashtoj se edhe vetë realtorja ka konkluduar se vendimet e mia janë të ndarë në pjesë të veçanta dhe se rrethanat e faktit janë gjithmonë të ndara nga vlerësimi i gjykatës. Gjithashtu, nuk mungon në asnjë rast ndarja në paragrafë të ndryshëm, por normalisht ndarja e paragrafit

vjen në momentin kur duhet të analizohet një rrethanë apo pretendim i ri. Nuk mund të bëhet ndarja në paragrafë domosdoshmërisht sepse relatorja çmon se duhet të jetë pak më i gjatë një paragraf në një moment të caktuar. Nuk qëndron as konkluzioni se tek pjesa e rrethanave të faktit paskam përfshirë procedurën që duhet ndjekur padia deri në momentin që ajo është marrë në shqyrtim. Nuk ka asnjë rast të tillë në vendimet e mia dhe siç kam cituar më sipër në çdo vendim themeli ekziston pjesa që titullohet “procedura” dhe aty trajtohet çdo aspekt i ndërmjetëm, çdo aspekt procedural dhe nuk ka ndodhur në asnjë rast që këto aspekte të jenë trajtuar veçmas. Më fal, -të bashkuara.

Gjithashtu, relatorja parashtrohet se pretendimet e palëve pasqyrohen edhe tek pjesa e përshkrimit të faktit si dhe te pjesa e arsyetimit të vendimit. Nuk mendoj se ka ndonjë gabim në këtë rast, duke qenë se pretendimeve të palëve i jepet zgjidhje dhe përgjigje pikërisht tek pjesa arsyetuese. Si rrjedhojë, vlerësoj se nuk janë të drejta pasi këto pretendime përveçse janë pasqyruar në fund të analizës mbi faktet e çështjes dhe jo si pjesë integrale e saj sikurse konstatohet, sigurisht që do të rimerreshin në analizë në pjesën e “analizës ligjore”.

Për sa i përket ligjit të zbatueshëm, relatorja citon se në disa vendime mungon evidentimi i qartë dhe i plotë i ligjit të zbatueshëm.

Atëherë, për sa i përket pretendimit të gjyqtarës për strukturimin, atë që kam vendosur theksin tek gjyqtarja në rastin konkret, është se ajo përdor fjali tematike në çdo rast, vendimet janë me pjesë përshkruese, rrethanat dhe faktet, procedura, ligji i zbatueshëm, arsyetimi ligjor, por ajo që kam konstatuar është se këto nënpjesë nuk janë të ndara në paragrafë. Pasqyrimi i rrethanave të fakteve por edhe arsyetimi ligjor në disa raste... në fakt pasqyrimi i fakteve në shumicën e rasteve janë të tilla, pasqyrohet si një e tërë. Nuk ka asnjë paragraf, asnjë fjali kryeradhë, por pasqyrohen si një e tërë, duke vazhduar edhe me tre faqe pasqyrimi i fakteve si një i tërë. Po aty pasqyrohen edhe pretendimet e palëve. Nuk e kam quajtur gabim dhe nuk e quaj gabim një mënyrë arsyetimi faktin se gjyqtarja ka analizuar pretendimet e palëve në arsyetim. Ajo duhet të bëhet patjetër. Por e kam parashtuar në mënyrën se si i strukturon, jo pse i ka arsyetuar dhe pse s’duhet arsyetuar. Tek arsyetimi ligjor e kam theksuar që gjyqtari analizon

pretendimet e palëve, por mënyra e strukturimit të vendimit nuk i jep qartësi dhe e bën të lodhshme më shumë qartësinë e vendimit. Kjo është ajo që kam konkluduar.

Tek pjesa e “Cilësisë së analizës dhe argumentit logjik”.

Nga analiza e burimeve për këtë tregues rezulton se në vendimet e analizuara përgjithësisht rezulton një nivel shumë i mirë arsytimi, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm të vlerësuar nga gjyqtarja në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale të gjykimit, kryesisht çështje të kompetencës lëndore; përcaktimit të barrës së provës dhe rolin e gjykatës në funksion të vlerësimit të shkakut ligjor të padisë; rolin dhe funksionin e gjyqtarit të seancës paraprake dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes.

Arsytimi i vendimeve përfundimtare, pas përcaktimit të fakteve të çështjes, zhvillohet mbi një analizë juridike të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, duke bërë një analizë tërësore dhe koncize të provave të administruara, në funksion të përcaktimit të qartë të fakteve të vlerësuara si të provuara. Në pjesën më të madhe të vendimeve, konstatohet se gjyqtarja i kushton rëndësi identifikimit dhe analizës së koncepteve ligjore të së drejtës materiale ose procedurale në lidhje me konkluzionet e arritura për zgjidhjen e çështjes, duke bërë një analizë për qëllimin dhe funksionin përkatës të dispozitave, si dhe të zbërthimit të kushteve apo elementëve të nevojshëm me qëllim që dispozita përkatëse të gjejnë zbatim në rastet konkrete në shërbim të konkluzioneve të arritura. Por në disa vendime të tjera burim vlerësimi nuk rezulton e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të zhvillimit të analizës ligjore dhe argumentit logjik, pasi analiza përqendrohet kryesisht në interpretimin abstrakt të dispozitave, duke e shoqëruar, thuajse gjithmonë me praktikën e unifikuar të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, apo dhe të qëndrimeve të mbajtura nga Gjykata Kushtetuese, pa u analizuar në raport me faktet e provuara në funksion të mbështetjes së marrëdhënies shkak-pasojë, e cila jo gjithmonë paraqitet e qartë.

Arsytimi i vendimeve përgjithësisht është i qartë dhe gjithëpërfshirës, duke marrë në analizë dhe duke i dhënë përgjigje pretendimeve dhe kërtimeve të palëve si dhe çështjeve të ngritura kryesisht për diskutim nga ana e gjyqtares. Pra edhe këtu kam

theksuar që gjyqtarja i jep përgjigje pretendimeve të palëve.

Më pas janë analizuar burimet e vlerësimit në vendimet civile, në vendimet penale, karakteristikat e gjyqtares.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në të gjitha vendimet burim vlerësimi rezulton se ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsytimit me të cilën lidhet pretendimi. Unë e kam theksuar edhe këtu që pretendimet lidhen me atë pjesë të cilën i paraqet pretendimi dhe nuk e kam theksuar që duhet të jetë tek rrethana e fakteve apo pas rrethanave të faktit, thjesht duhet të jenë të lidhura, por kam thënë tek pjesa e strukturimit që nuk paraqiten të qarta por vijnë njëra pas tjetrës, domethënë si fjali vazhduese, duke vazhduar një mendim 3 faqe.

Pretendimet e palëve përgjithësisht kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsytimit tërësor.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke i vlerësuar tërësinë e tyre në raport me natyrën e çështjeve, komplekse ose jo, rezulton se gjyqtarja ka aftësi mbi mesatare në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Konstatohet së vendimet gjyqësore burim vlerësimi, në varësit të kompleksitetit të çështjeve dhe pretendimet e palëve, në pjesën analitike të tyre përmbajnë argumente të lidhura me njëri-tjetrin, duke i ndalur tek evidentimi i lidhjes shkak- pasojë në raport me konkluzionet për zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja i kushton rëndësi analizimit të pretendimeve të palëve në raport me rrethanat konkrete të çështjes, duke i dhënë përgjigje të argumentuar si për çështjet e procedurës ashtu dhe ato për themelin. Megjithatë, referuar burimeve të vlerësimit nuk evidentohet e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të analizës dhe argumentit logjik, pasi elementi analitik në pjesën më të madhe të vendimit dominohet nga analiza abstrakte e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, duke u pasuruar me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, dhe një pjesë me e vogël në përshkrimin dhe analiza e fakteve të çështjes, pa i ndërthurur këto të fundit me interpretimin e ligjit të zbatueshëm dhe më

tej në dhënien e arsyeve për mënyrën e zbatimit të tij mbi faktet e çështjes. Përgjithësisht, arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Për këtë nëntregues është propozuar vlerësimi i saj “mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për “Aftësitë profesionale të gjyqtarës” është 88 pikë, "Shumë mirë".

Për sa i përket “Aftësi organizative të gjyqtarës”. Në fakt gjyqtarja edhe këtu ka paraqitur kundërshtime, megjithëse është vlerësuar 100 pikë, duke pretenduar se nuk njoh ligjin në një dispozitë. Aty është pasqyruar që gjyqtarja nuk ka zbatuar afatin e njoftimit të parashikuar nga ligji procedural penal për njoftimin e palëve, caktimin e seancës së parë, ashtu siç parashikohet në ligj. Nga ana e relatores, apo edhe Këshillit, nuk është vlerësuar se kush dispozitë është më e përshtatshme apo jo e përshtatshme, është vlerësuar që kjo dispozitë është respektuar në atë rast. Megjithatë, pasur parasysh gjithë tërësisë së çështjes është vlerësuar maksimalisht për çdo kriter.

Gjithashtu, konstatohet se thotë në një nga rastet, për pjesën e arsyetimit të vendimeve (megjithëse thashë është vlerësuar me pikët maksimale), ashtu siç është pasqyruar edhe në raportin analitik ashtu edhe në projektraport është vlerësuar se njëri nga nëntreguesit, në njërin nga kategoritë e vendimeve është arsyetuar tej afatit ligjor, siç parashikon ligji 48 orë. Gjithashtu edhe gjyqtarja thotë unë nuk identifikoj se kush është vendimi. Në fakt ato janë disa vendime dhe janë vendime të cilat është marrë parasysh edhe ndryshimi ligjor në 2017, ashtu siç është marrë parasysh në çdo nëntregues për rastet kur pavarësisht raportit analitik, janë bërë edhe një herë vlerësimi i analizave statistikore dhe janë ndryshuar këto të dhëna duke i ulur në fakt edhe përqindjen e afatit ligjor dhe çështjet e standardit minimal.

Gjithsesi, gjyqtarja ndër të tjera i ka pasur edhe statistikat dhe mund t'i identifikonte vetë se ku unë nuk i kam pasqyruar të saktë.

“Respektimi i afateve ligjore” –

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 747 çështje për të cilat ligji parashikon afat, 182 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati ndërsa 505 çështje janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor, në raport me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 24.4 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Më pas, pasur parasysh kundërshtimet e gjyqtares të cilat janë paraqitur tek formulari i integruar i vlerësimit të gjyqtarit, duke marrë parasysh, duke zbritur lejen vjetore dhe festat e fundvitit, janë konsideruar edhe një herë të dhënat statistikore, janë marrë edhe një herë në analizë të dhënat statistikore. Pasur parasysh edhe shpjegimet e gjyqtares të bërë në raportin analitik dhe janë pasqyruar në ato raste kur është zbritur ky afat dhe çështjet janë llogaritur brenda afatit ligjor pasur parasysh edhe parashikimet ligjore të cilat kanë ndryshuar.

Për pasojë, duke konsideruar (i) shpjegimet e gjyqtares lidhur me shortimin dhe planifikimin e çështjeve dhe (ii) tejkalimin e afatit me 1 ose 2 ditë (i cili është konsideruar i papërfillshëm), (iii) pushimet e vitit vjetore apo të Vitit të Ri si dhe ndarjen e dosjeve, janë zbritur edhe 73 çështje të tjera në ndryshim nga raporti analitik të cilat kanë rezultuar të përfunduara brenda afatit ligjor.

Kështu, pasi janë konsideruar këto të dhëna... është marrë në tejkalim të afatit ligjor, ka rezultuar se 109 çështje janë konsideruar të cilat nuk janë zbatuar afati ligjor, duke e zbritur përqindjen në 14.6 %, përqindje e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 12 pikë.

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, si dhe duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtarja ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare objekt vlerësimi 2334 çështje, nga të cilat 747 çështje parashikojnë afati ligjore, nga të cilat 612 janë çështje civile themeli, pra mesatarisht 778 çështje në vit, pa përfshirë këtu ngarkesën si anëtare e trupit gjykues.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përlllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, përjashtohen çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (deri në 2 ditë), atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte të jenë 109 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor, me numrin total të çështjeve të gjykuara (747 çështje), rezulton të jetë 14,6 % të çështjeve të përfunduara tej afatit, përqindje që sipas metodologjisë vlerësohet me 12 pikë. Por për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit: (i) raportit të çështjeve të gjykuara në tejkalim të afatit, që rezultojnë në 14.6% (ii) ngarkesën e gjyqtarës si relatore, duke gjykuar mesatarisht rreth 778 çështje në vit nga të cilat 248 janë me afat ligjore dhe (iii) aspektet që lidhen me kushtet e punës, konkretisht angazhimin si anëtare e trupit gjykues, kohën që gjyqtarja kalon në zhvillimin e seancave, gjyqtarja për këtë tregues vlerësohet në nivelin maksimal, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Sa më sipër, për këtë tregues është propozuar pikëzimi i saj me 15 pikë, duke e konsideruar brenda marzhit 0-10%.

Për treguesin e dytë “Plotësimi i standardeve minimale”, nuk ka paraqitur kundërshtime. Janë analizuar të gjitha çështjet për të cilat janë zbritur dhe janë konsideruar në standard.

Konkluzion: Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve që rezulton 11%; (ii) faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit referuar shkaqeve të bëra prezent nga

gjqtarja në vetëvlerësimin e saj, të cilat përgjithësisht nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit dhe (iii) tejkalimin e standardit sasior të zbatueshëm në masën 30,7%, (iv) numrin teje të lartë të çështjeve të gjykuara brenda 3 vjetëve, prej 2334 çështje, nga të cilat 744 kanë qenë me afat ligjore, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

Referuar sa më sipër, lidhur me këtë tregues, vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 11 % të çështjeve jashtë standardit minimal ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit sikundër është treguesi sasior i punës së saj (tejkallim i standardit sasior me 30,7%) si dhe gjykimi i një numri prej 744 çështje me afat ligjor.

“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” –

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Referuar metodologjisë, duke qenë se shumicën e kategorive të çështjeve (11 nga 12 kategori), koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, përveç kategorisë “Tregtare pa palë kundërshtarë”, ku standardi minimal kohor është tejkaluar me vetëm 9 ditë, çka vlerësohet tejkalim i papërfillshëm, gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues, me 5 pikë.

“Rendimenti i përfundimit të çështjeve” –

Nga analizimi i burimeve të vlerësimit rezulton se rendimenti i gjyqtarës është 114,6% përqindje e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 10 pikë, duke qenë se rezulton mbi 99 %. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj me 10 pikë.

“Koha mesatare e arsyetimit të vendimeve” -

Nga burimet e vlerësimit të ndara në disa kategori, vendimet janë të grupuara në disa kategori, referuar të dhënave statistikore, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve është tejkaluar vetëm në 1 nga 17 kategoritë e çështjeve, konkretisht në kategorinë e çështjes “kërkesa penale të hetimit paraprak” me objekt “verifikim kushtesh dhe kriteresh të caktimit të masës së sigurimit dhe shuarje mase sigurimi”. Referuar

metodologjisë, kur koha e arsytimit është më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve, i korrespondon pikëzimit me 12 pikë.

Referuar metodologjisë së pikëzimit, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve duke zbatuar më pas një koeficient jo më shumë se 20%.

Në rastin konkret, duke marrë në konsideratë volumin e çështjeve, ku rezultoi se për një periudhë trevjeçare gjyqtarja ka dhënë rreth 2334 vendime, mesatarisht rreth 778 vendime në vit, apo rreth 70.7 vendime në muaj, dhe mesatarisht 3.37 vendime në ditë, është vlerësuar se ky pikëzim të shkojë në pikëzimin maksimal duke e rritur me një nivel dhe duke e pikëzuar me 15 pikë.

“Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore”, për kategoritë e çështjeve është përcaktuar numri i seancave, ku ka rezultuar: për kategorinë “penale themeli” është 1.3; për kategorinë “seanca paraprake”, “dërgim çështje në gjyq” është 4.8; për kategorinë “çështje familjare” është 2.7; për kategorinë “civile me palë kundërshtare” është 3.

Në tërësinë e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare, rezulton të jetë 2,95 seanca. Janë marrë parasysh edhe të gjithë veprimet e gjyqtarës. Në konkluzion, nga sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri i seancave është 2,95 seanca dhe në çdo rast gjyqtarja ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave, shkalla e aftësisë duhet të vlerësohet në nivel maksimal, duke e pikëzuar me 15 pikë. Pra për këtë tregues, propozohet vlerësimi i saj me 15 pikë.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”-

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja jo vetëm i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën, por duke treguar edhe kujdesin maksimal për marrjen e masave për njoftimin e palëve, etj.

Në dosje të vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, por

edhe në vonesa të cilat variojnë nga 5 minuta deri në 60 minuta vonesë, dhe gjithashtu rezulton që të jetë relatuar shkaku nga ana e gjyqtarës në lidhje me shkaqet e fillimit të seancave me vonesë, kryesisht për shkak të gjykimeve të mëparshme. Pavarësisht kësaj, nuk ka rezultuar në asnjë rast që vonesa të jetë bërë shkak për moszhvillimin e seancave.

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë duke respektuar të drejtat e palëve.

Pas analizimit të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

“Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen” –

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik (sipas kategorisë) dhe kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal dhe aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen lehtësisht.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë.

“Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit” –

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues. Në dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete. Pas analizimit të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit për kriterin “Aftësia organizative të gjyqtarit” është “Shkëlqyeshëm” duke e pikëzuar me 100 pikë.

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, “Etika në punë”.

Janë marrë në analizë informacionet e përcjella nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë për ankesat që janë shqyrtuar. Nuk është gjetur asnjë e dhënë lidhur me etikën e gjyqtarit.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjësisë në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjësisë në funksion.

Referuar sa më sipër, për këtë tregues është propozuar aftësia e saj shumë e lartë, duke u pikëzuar me 35 pikë.

Integriteti i gjyqtares, “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” –
Është administruar raporti i ILDKPI-së lidhur me këtë tregues.

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin.

Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e integritetit të gjyqtares për këtë tregues është shumë e lartë duke u pikëzuar me 40 pikë.

Paanësia – “Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese” –

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese dhe është propozuar vlerësimi i saj me 10 pikë.

“Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares”

—

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se

për periudhën e vlerësimit janë paraqitur 6 (gjashtë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, nga të cilat është pranuar vetëm 1 (një) prej tyre. Po kështu, rezulton se edhe vetë gjyqtarja ka paraqitur 59 (pesëdhjetë e nëntë) kërkesa për heqje dorë, nga të cilat nuk është pranuar vetëm 1 (një).

Nga kryetarja e gjykatës dhe gjyqtarja është vlerësuar se numri i kërkesave për përjashtim është i pakonsiderueshëm.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se numri i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtares është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, nga 6 kërkesa të paraqitura për përjashtimin e saj është pranuar vetëm 1 prej tyre. Për këtë arsye, për këtë tregues është propozuar pikëzimi i saj me 15 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është 100 pikë, “Shkëlqyeshëm”.

Sa i përket “Aftësisë personale dhe angazhimi profesional”, konkretisht për treguesin “Aftësia e komunikimit”, në tërësi nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj me 25 pikë për këtë tregues.

“Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, edhe për këtë tregues është propozuar pikëzimi i saj me 15 pikë, duke qenë se nuk ka të dhëna.

Sa i përket “Aftësisë për të bashkëpunuar”, në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj me 15 pikë.

“Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” –

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit është shumë e lartë. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj me 10 pikë. Aftësia është shumë e lartë.

“Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, “Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës” –

Rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në 24 aktivitete trajnuese të zhvilluara gjatë

periudhës së vlerësimit, të ndarë në 39 ditë.

Për këtë arsye, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit kohëzgjatje është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj me 20 pikë.

“Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional” –

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses apo ekspertes.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësuese apo eksperte në Shkollën e Magjistraturës, është propozuar pikëzimi i saj me 3 pikë.

“Pjesëmarrja e gjyqtarës në veprimtari ndërinstitucionale” –

Nga analiza e burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në formularin e vetëdeklarimit gjyqtarja ka pasqyruar se është angazhuar në disa aktivitete. Gjithashtu ky pretendim është pasqyruar edhe në raportin e vlerësimit të kryetares.

Në lidhje me treguesin, gjyqtarja në datën 24.10.2022, nëpërmjet postës elektronike ka dërguar urdhrin me nr. 380, datë 16.10.2017 për pjesëmarrjen për marrjen e masave për zbatimin e memorandumit të bashkëpunimit “Për më shumë akses në drejtësi nga gratë dhe burrat shqiptarë”; urdhrin e kryetarit të gjykatës 02.05.2018; urdhrin e kryetarit të gjykatës së datës 12.04.2017 “Për miratimin e objektivave të brendshëm të gjykatës për menaxhimin më të mirë të kohës”.

Referuar Raportit Analitik, nuk evidentohen të dhëna në lidhje me këtë kriter, përveç deklarimeve të gjyqtarës dhe kryetares së gjykatës që konfirmon deklarin e gjyqtarës, pasi urdhrat e paraqitura në cilësinë e provës nuk vërtetojnë angazhimin e gjyqtarës në këto veprimtari.

Bazuar në sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton

se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në vullnetin e gjyqtarit, është propozuar vlerësimi i saj me 3 pikë. Edhe për këtë tregues gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime, duke paraqitur një vërtetim të lëshuar nga projekti i USAID-it, ku tregon angazhimin e saj në veprimtari për sa i përket zbatimit të një programi për drejtësi pa vonesë, provë e cila është paraqitur edhe tek projektraporti i vlerësimit për periudhën 2013-2016.

Edhe për këtë nëntregues vlerësoj se pjesëmarrja në këto takime apo provat e paraqitura në një rast që gjyqtarja ka paraqitur edhe fotografitë në të cilën ka shkuar në një aktivitet të zhvilluar në Kosovë, vlerësoj se nuk përfshihet në kategoritë e veprimtarive ndërinstitucionale, siç përcakton rregullorja.

Për këto arsye i qëndroj propozimit me 3 pikë.

“Publikimet ligjore”-

Nuk rezultojnë të dhëna që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore për periudhën e vlerësimit, për pasojë duhet të pikëzohet me 0 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit të kriterit “Aftësia personale dhe angazhimi profesional” është "Shkëlqyeshëm" me 91 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe niveli i përgjithshëm është si më poshtë:

Aftësitë profesionale të gjyqtarës, 88 pikë, "Shumë mirë";

Aftësitë organizative të gjyqtarës, 100 pikë, "Shkëlqyeshëm";

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë, "Shkëlqyeshëm";

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, 91 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Vlerësimi i përgjithshëm, 379 pikë, "Shumë mirë".

Propozime dhe rekomandime:

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve”, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandoj që gjyqtarja {...} t’i kushtojë më shumë rëndësi pjesës arsyetuese të vendimit dhe jo asaj përshkruese, strukturimit të mendimit juridik në mënyrë që të jetë lehtësisht i kuptueshëm, të mbajë në konsideratë angazhimin e saj në aktivitete për trajnimin e

gjqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstytucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale.

Kjo ishte në mënyrë të përmbledhur. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ftoj anëtarët e Këshillit nëse kanë diskutime për sa u parashtrua.

Po, zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: I nderuar zoti Zëvendëskryetar!

Sot ne kemi projektraportin për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...} për periudhën 2017-2019. Ne jemi njohur të gjithë me pjesën e raportit, metodologjinë dhe jemi të njohur se si realizohet një veprimtari e tillë nga ana e Komisionit të Etikës. Pra jemi të gjithë të njohur edhe me aktet të cilat janë përpiluar, e cila për hir të së vërtetës është një punë voluminoze e cila është bërë si nga ana e nëpunësit përgjegjës, ashtu edhe relatores apo edhe Komisionit.

Ajo që më bën mua përshtypje sot janë kundërshtimet që ka bërë gjyqtarja për sa i përket raportit. Një gjyqtare e këtij kalibri nuk mundet dhe është e patolerueshme për mua (pastaj do ta vlerësojmë të gjithë bashkë) të flasë në këtë gjuhë për sa i përket mënyrës se si është sjellë me relatoren. Për mua, unë prisja një reagim tjetër edhe nga Komisioni dhe nga relatorja. E shtroj këtë dhe do dalë me një pyetje. Nuk mundet që të vijë një gjyqtare me atë përvojë që ajo ka dhe të flasë me këtë gjuhë, të përdori edhe metafora apo të përdori ironi, dhe në fund bën edhe aludime se si janë bërë raportet e të tjerëve. Ne e dimë se si bëhet një vlerësim, pra bëhet akti dhe gjyqtarja, jo vetëm ajo, por të gjithë gjyqtarët e republikës kanë të drejtën edhe të vijnë. Për mua kjo gjyqtare duhet të ishte këtu sot, të vijë këtu dhe të japë shpjegime, edhe për aludimet që ajo ka, se si është bërë një raport apo se si kemi arritur ne në një konkluzion. Prandaj, për të mos ju lodhur dhe për t'i rënë sa më shkurt, pyetja ime është:

- Nëse këto etika komunikimi që ne flasim dhe i mëshojmë kaq shumë me palët, me njerëzit, me kolegët, a mos ka këtu ndonjë vend për të bërë një rishikim për sa i përket

kësaj pjese, për qëndrimin që ka mbajtur gjyqtarja me Këshillin, me relatoren dhe me Këshillin? Kjo është pyetja që dua të bëj. Nëse kemi ndonjë mundësi që ta rishikojmë këtë dhe pastaj të vijojmë procedurat e tjera. Ju faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hallunaj!

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti zëvendëskryetar!

Në fakt edhe unë ngre të njëjtën problematikë që ngriti zoti Hallunaj, por mendoja se do kishim propozime për sa i përket kundërshtimeve që ka bërë gjyqtarja lidhur me kritere të caktuara dhe pastaj do ta merrja fjalën, sepse propozimi im është i ndryshëm nga ai që ka bërë relatorja e çështjes për kriterin e etikës specifikisht.

Kemi vlerësuar këtu gjyqtarë me përvojë 20-vjeçare, 25-vjeçare dhe më tej dhe asnjë gjyqtar nuk ka ngritur, nuk ka përdorur gjuhë tallëse, fyese, sarkazma, aludime, për standardin e vlerësimit. Këto kundërshtime nuk janë kundërshtime për projektraport vlerësimi, janë kundërshtime të atakuara personalisht kundër relatores së çështjes, duke aluduar për qëndrime të ndryshme apo mënyrën se si vlerëson e njëjta relatore gjyqtarë të ndryshëm, duke shprehur gjyqtarja një formë revolte që paska punuar kot, dhe nuk është aspak e drejtë. Kjo mënyrë se si ajo menaxhon emocionet e veta dhe nuk tregon vetëpërmbytje për të kundërshtuar një projektraport vlerësimi. Nëse nuk është dakord me konkluzionet e caktuara, shpreh qëndrimin e vet. Nuk ka pse përdor emocione negative, tregon mungesë respekti, mungesë vetëpërmbytje, duke atakuar relatoren e çështjes apo edhe Këshillin.

Edhe unë ndaj të njëjtin shqetësim nga zoti Hallunaj dhe duke marrë parasysh që pavarësisht se në periudhën e vlerësimit, nga të dhënat e burimeve të administruara deri tani nuk ka pasur të dhëna që mund të flisnin për cenimin e etikës, ju bëj me dije që në zbatim të ligjit “Për statusin”, neni 77, pika “g”, kundërshtimet e magjistratit në seancë dëgjimore, përbëjnë burim vlerësimi. Edhe unë do të doja shumë që ndoshta gjyqtarja të vinte sot dhe këto të na i thoshte përballë të gjithë anëtarëve të Këshillit, përballë ndoshta

edhe me pyetje nga ana jonë, për mënyrën e paprecedent se si shkruan në kundërshtimet ndaj projektraportit të vlerësimit.

Gjuha e përdorur për mendimin tim tregon mungesë respekti dhe vetëpërmbytje nga ana e gjyqtares për të kundërshtuar projektraportin e vlerësimit, prandaj vlerësoj që duhet të afektojë kriterin e “Etikës në punë” të gjyqtares. Për këtë arsye propozoj që për kriterin e “Etikës në punë”, gjyqtarja të mos vlerësohet me aftësinë e saj “shumë të lartë”. Jam në diskutim midis “mesatare” apo “mbi mesatare”, por duke qenë se nuk kemi të dhëna nga burime të tjera, do të propozoja shkallën “mbi mesatare”, jo 35 por 28 pikë.

Nuk e di nëse nga anëtarë të tjerë të Këshillit ka qëndrim ndryshe.

Një shkallë. Siç kemi bërë edhe në raste të tjera.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Po, zonja Plaku!

Irena Plaku: Në fakt, të gjitha këto konstatime i kam konstatuar normalisht, dhe faleminderit që i evidentuat, sepse nuk doja t’i evidentoja vetë. Pse? Sepse mos të dukesh që e kisha personale. As nuk e njoh gjyqtaren personalisht. Mund ta kem parë si fytyrë, vetëm kaq, por është shumë ofenduese mënyra e të shkruarit të saj. Duke qenë se unë e kam vlerësuar projektraportin mbi ato burime të vlerësimit, nuk kam dashur që të propozoj një nivel të ndryshëm, të mos dukej si hakmarrje në fakt, por nuk është se është hakmarrje. Por gjuha e përdorur është shumë ofenduese dhe fyese, ndaj meje si relatore sidomos. Gjithsesi, në qoftë se i qëndroni propozimit, unë jam dakord me propozimin e parashtruar nga zonja Lubonja.

(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Ilir Rusi: Ftoj zonjën Ukperaj për të perifrazuar propozimin për rastin që kemi në shqyrtim.

Brikena Ukperaj: Pa përsëritur arsyetimin e bërë më parë, unë propozoj që bazuar në kundërshtimet e gjyqtares dhe gjuhën e përdorur në to, kundërshtime që përbëjnë burim vlerësimi sipas ligjit, Këshilli të vendosë ndryshimin e pikëzimit për sa i përket treguesit “Etika në punë”, është treguesi 3A, “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion”, duke e pikëzuar gjyqtaren me 28 pikë për aftësi “mbi mesatare”, jo për 35 pikë, pasi referuar ligjit dhe metodologjisë, në vlerësimin tim ka treguar mungesë vetëpërmbytjeje dhe respekti në mënyrën e formulimit të kundërshtimeve ndaj raportit të vlerësimit, duke atakuar relatoren e çështjes.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ftoj anëtarët për votimin e propozimit.

Irena Plaku: Dakord me propozimin.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Miratohet propozimi i zonjës Ukperaj.

Ftoj relatoren zonjën Plaku për të bërë reflektimet përkatëse për të vazhduar më tej me shqyrtimin e rastit.

Irena Plaku: Propozimi për katër kriteret pas propozimit të miratuar është si më poshtë:

“Aftësia profesionale e gjyqtares”, 88 pikë”, "Shumë mirë";

“Aftësia organizative e gjyqtares”, 100 pikë, "Shkëlqyeshëm";

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, 100 pikë, "Shkëlqyeshëm";

“Aftësia dhe angazhimi profesional”, është 84 pikë, "Shumë mirë".

Vlerësimi i përgjithshëm është...

Me fal edhe një herë.

Atëherë, propozimi është si më poshtë:

88 pikë për “Aftësitë profesionale të gjyqtares”;

“Aftësia organizative e gjyqtares”, 100 pikë;

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është 93 pikë, "Shkëlqyeshëm";

“Aftësia personale dhe angazhimi profesional” është 91 pikë.

Vlerësimi i përgjithshëm është “Shumë mirë” me 372 pikë.

Ilir Rusi: Ju faleminderit!

Mbas reflektimeve të propozimit të bërë nga relatorja zonja Plaku, ftoj anëtarët e Këshillit për miratimin e projektvendimit përkatës, duke marrë në konsideratë miratimin e propozimit të zonjës Ukperaj dhe reflektimet e bëra nga relatorja.

Dritan Hallunaj: Pro.

Irena Plaku: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017-2019”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, të gjyqtares {...}, për periudhën 2017-2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shumë mirë”;

- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.03.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës [...], për periudhën 2017-2019, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 15:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|---------------------------------|
| 1. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 3. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Dritan Hallunaj | <i>(anëtar)</i> |
| 5. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 6. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Marçela Shehu | <i>(anëtare)</i> |
| 8. Brikena Ukperaj | <i>(anëtare)</i> |
| 9. Yllka Rupa | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami* si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani dhe Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Të tjerë: Edmond Hoxhaj (BIRN).*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës [...], për periudhën 2017-2019, relatore *znj. Brikena Ukperaj*.

Ilir Rusi: Për më tej, vazhdojmë me pikën 3 të rendit të ditës: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës [...], për periudhën 2017-2019. Ftoj relatoren *zonjën Ukperaj* për rastin.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Zonja [...] ka qenë e përfshirë në programin e vlerësimit të gjyqtarëve për periudhën e vlerësimit 2017-2019. Dosja e saj e vlerësimit është plotësuar me materialet në datën 25.01.2023, moment nga i cili ka filluar përpilimi i Raportit Analitik dhe projektraportit të vlerësimit. E gjithë procedura e ndjekur shpjegohet në pjesën hyrëse të projektraportit të vlerësimit me të cilin gjyqtarja është njohur dhe në rrugë elektronike ka

konfirmuar që nuk ka kundërshtime, nuk ka kërkesa për prova të tjera dhe nuk ka kërkuar të dëgjohet në seancë dëgjimore.

Në kushtet kur projektraporti i vlerësimit shoqërohet nga analiza e detajuar e të dhënave statistikore dhe të dhënave të tjera të burimeve të vlerësimit, unë do të ndalem vetëm në konkluzionet e çdo treguesi, sipas propozimit që kam sot për plenaren.

Për sa i përket “Aftësive profesionale të gjyqtarës”, aspekti i “Njohurive ligjore”, “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”. Pas analizës së burimeve të vlerësimit lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, përcaktimin e ligjit të zbatueshëm civil, penal, material, procedural, si dhe evidentimit të rasteve të konfliktit të normave, kam konstatuar se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshje, dhe kam propozuar pikëzimin me 25 pikë.

Për sa i përket “Aftësisë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, duke evidentuar aftësinë e gjyqtarës në interpretimin e dispozitave materiale civile, penale dhe atyre procedurale, civile, penale, përdorimit të jurisprudencës relevante dhe parimeve të përgjithshme të së drejtës, kam konkluduar se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën relevante gjyqësore, parimet e përgjithshme të së drejtës dhe standardet e procesit të rregullt ligjor. Në mbështetje të analizës juridike të çështjes, gjyqtarja referon edhe në qëndrime të praktikës gjyqësore lidhur me koncepte të caktuara juridike, duke i dhënë vlerë të shtuar dhe duke qartësuar kuptimin e ligjit të zbatueshëm. Këtij të fundit në të gjitha vendimet e analizuarat i bëhet një zbrëthim abstrakt i çdo elementi, bazuar në qëllimin e normës, mbi të cilin gjyqtarja bazohet për t’ i dhënë përgjigje shkaqeve të ngritura në ankim (duke qenë se jemi përpara një gjyqtareje që ka gjykuar në Gjykatën e Apelit). Për këtë arsye shkalla e aftësisë së gjyqtarës lidhur me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” propozohet të

vlerësohet shumë e lartë nga ana e Këshillit duke e pikëzuar me 25 pikë.

Për sa i përket treguesit të “Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit”, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit pa përsëritje, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike. Pjesët e vendimit përgjithësisht fillojnë me një fjali tematike, e cila shpreh idenë kryesore të mendimit të asaj njësie ose konkluzionin mbi të cilin shtjellohen argumentet mbështetëse. Kjo mënyrë e të shkruarit i shërben jo vetëm qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, pa përsëritje dhe rikthim në çështje të analizuar më parë, por dëshmon qëndrueshmëri dhe rrjedhshmëri të paraqitjes së argumenteve. Propozimi, shkallë shumë e lartë aftësisë, pikëzimi me 15 pikë.

Për sa i përket “Strukturës së qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit”, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të tillë duke ndjekur rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor. Përdor një metodologji të unifikuar në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual ashtu edhe në përmbajtje. Propozimi, shkallë shumë e lartë aftësie, pikëzimi me 10 pikë.

Për sa i përket treguesit të fundit të kriterit të parë “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, duke evidentuar në projektraport të gjithë analizën që ka bërë gjyqtarja koncepteve të caktuara apo fakteve të çështjes mbi çështjet e ngritura prej saj për zgjidhje kam konkluduar se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”. Ajo analizon në mënyrë të plotë dhe të qartë faktet e çështjes, për të vijuar me analizën e koncepteve ligjore që i shërbejnë zgjidhjes së saj, mbi bazën e një zhvillimi dhe argumentimi logjik mbi mënyrën e aplikimit të tyre mbi rastin në shqyrtim. Gjyqtarja e zhvillon argumentimin e saj duke ndjekur logjikën e zhvillimit të marrëdhënies shkak-pasojë, si dhe duke u kujdesur për të marrë në analizë dhe për t’i dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha shkaqeve të ngritura në ankim, në përmbushje të standardit të procesit të rregullt ligjor. Propozohet pikëzimi me 25 pikë, shkallë shumë e lartë aftësie.

Përfundimisht për kriterin e parë “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i përket “Aftësive organizative”, “Respektimit të afateve ligjore”, pas një analize të detajuar të çdo të dhëne në tabelat statistikore, si dhe bazuar në një analizë logjike mbi afatet e përfundimit të çështjeve, referuar edhe ndryshimeve të Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të Procedurës Penale që kanë ndodhur në këtë periudhë, ka rezultuar se 238 çështje gjithsej, të cilat kanë të parashikuara afat ligjor për përfundimin e tyre, gjyqtarja ka përfunduar jashtë afatit 35 çështje ose rreth 14.7% të çështjeve, përqindje e cila në metodologji pikëzohet me 12 pikë.

Nga ana tjetër, metodologjia, lidhur me këtë tregues, ka përcaktuar hapësirën e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti, ngarkesa, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, me qëllim për të shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret, pavarësisht numrit të çështjeve për të cilat ligji parashikon afate ligjore gjykimi për gjykimin në apel, rezulton se gjyqtarja ka pasur një ngarkesë të lartë çështjesh në periudhën e vlerësimit, ka gjykuar 836 çështje si relatores dhe 1612 çështje si anëtare.

Nga analiza logjike e të dhënave statistikore, duke marrë në konsideratë:

- i) ngarkesën e lartë të gjyqtares si relatores dhe anëtare;
- ii) mendimin e kryetarit dhe vetëvlerësimin e gjyqtares lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve për çështjet me afat ligjor;
- iii) gjendjen shëndetësore, si dhe faktin që gjyqtarja ka qenë me leje barrë lindje 4 mujore gjatë vitit 2017;
- iv) numrin e lartë të çështjeve me afat ligjor të cilat zënë rreth 28% të çështjeve totale të shqyrtuara gjatë periudhës së vlerësimit;
- v) tejkalimin e pragut të përqindjes që çon në pikëzim maksimal vetëm me 4,7 %; kam vlerësuar që për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë se ai që përkon me 14.7% të çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit duke u pikëzuar me 15

pikë.

Për sa i përket “Plotësimi të standardeve minimale kohore”, nga analiza e të dhënave statistikore vetëm 3% e çështjeve janë jashtë standardit minimal kohor në fuqi. Për këtë arsye propozoj pikëzimin me 5 pikë.

Për sa i përket “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, ka rezultuar më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve, dhe propozohet pikëzimi maksimal me 5 pikë, çka tregon që gjyqtarja, pavarësisht ngarkesës së lartë të çështjeve, ka treguar kujdes maksimal për zhvillimin e gjykimit brenda afateve të shkurtra.

Për sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve” si raport i çështjeve të përfunduara me ato të caktuara, ai rezulton në masën 106.49%, çka tregon evadimin e backlog-ut nga ana e gjyqtarës. Për këtë arsye pikëzohet me 10 pikë.

Për sa i përket “Kohës mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore”, ka rezultuar më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve. Pikëzimi 15 pikë, pikëzim maksimal.

Për sa i përket “Aftësisë për të kryer procedurat gjyqësor”, “Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive”, nga analiza e dosjeve të marra me short gjatë procedurës së vlerësimit, ka rezultuar se numri mesatar i seancave për çështje të kategorisë “civile me palë kundërshtare” ka qenë 1.2 seanca; për çështje penale të kategorisë “penale krime” numri mesatar ka qenë 4.3 seanca; për çështje “seancë paraprake” numri i seancave ka qenë 1 seancë. Në total numri mesatar i të gjitha seancave rezulton 2.6 seanca dhe gjyqtarja në çdo rast ka marrë masa për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Propozohet pikëzimi me 15 pikë.

Për sa i përket “Kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, në tërësi rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt

ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë në gjykimin civil dhe penal në apel. Propozohet shkallë shumë e lartë aftësie. 20 pikë.

Për sa i përket “Rregullshmërisë” dhe “Saktësisë së dosjes”, për dy treguesit e fundit të “Aftësive organizative”, propozohet shkallë shumë e lartë aftësie, 5 pikë për sa i përket rregullshmërisë dhe 10 pikë për sa i përket saktësisë dhe plotësisë së dosjes.

Përfundimisht, për kriterin e dytë “Aftësitë organizative të gjyqtarës” propozohet nivel shumë i lartë "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i përket “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, aspekti i parë “Etika në punë”, treguesi “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion”, nuk ka rezultuar që gjatë periudhës 2017-2019 ndaj gjyqtarës të jenë marrë apo të jenë zbatuar masa disiplinore. Ka pasur vetëm 4 ankesa të trajtuara nga ILD-ja për të cilat është marrë, edhe në rastet kur ka filluar verifikimi, arkivimi, me arsyetimin se nuk përmbajnë shkaqe dhe pretendime që lidhen me shkelje disiplinore apo se pretendimet e ngritura në to mund të zgjidhen në rrugën e ankimit gjyqësor. Nga ana tjetër edhe kryetari i gjykatës e ka vlerësuar shumë të lartë etikën dhe angazhimin në punë të gjyqtarës. Për këtë arsye nuk ka të dhëna që mund të afektonin këtë tregues dhe kam propozuar shkallë shumë të lartë aftësie, pikëzimi me 35 pikë.

Për sa i përket “Integritetit”, “Shmangies së shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti”, janë të njëjtat burime si tek etika. Nga ana tjetër është marrë parasysh edhe raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, i cili nuk ka gjetur problematika lidhur me konfliktin e interesit. Nga burimet e tjera të vlerësimit nuk ka të dhëna që mund të cenojnë integritetin, për këtë arsye, mbi bazën e parimit të prezumimit mbi të cilën është ndërtuar metodologjia, propozoj shkallë shumë të lartë aftësie. Pikëzimi 40 pikë.

Edhe për sa i përket “Përdorimit të gjuhës diskriminuese” nuk ka të dhëna. Propozohet shkallë shumë e lartë aftësie. Pikëzimi me 10 pikë.

Edhe për sa i përket numrit tejet të lartë të kërkesave të palëve për përjashtimin e gjyqtarës, vlerësoj se numri konsiderohet i pakonsiderueshëm në periudhën trevjeçare dhe kam vlerësuar pikëzimin me 15 pikë.

Përfundimisht, për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për kriterin e katërt “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë komunikimi të qartë dhe transparent, pikëzimi 25 pikë.

“Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” - nuk ka pasur të dhëna që mund të afektonin treguesin. Pikëzimi me 15 pikë.

“Aftësia për të bashkëpunuar” si me kolegët dhe me administratën gjyqësore duke përfshirë edhe shkëmbimin e njohurive me kolegët është shumë e lartë dhe për të dy treguesit pikëzimi është maksimal, 15 pikë dhe 10 pikë.

Për sa i përket “Gatishmërisë për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, “Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues”, ka rezultuar që gjatë gjithë periudhës së vlerësimit gjyqtarja ka marrë pjesë në 20 aktivitete trajnuese të shtrira në 41.5 ditë trajnimi si dhe 1 aktivitet trajnues jashtë Shkollës së Magjistraturës të shtrirë në tre ditë trajnimi, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15-20 ditë për të gjithë periudhën trevjeçare. Pikëzimi maksimal me 20 pikë.

Për sa i përket “Disponueshmërisë së gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, ka rezultuar që gjatë kësaj periudhe gjyqtarja ka pasur rolin e ekspertit dhe lehtësueses në programin e trajnimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për dy aktivitete (të cilat përmenden në projektraport) lidhur me *Njoftimet e veçanta dhe me mjete të tjera teknike* në fushën penale dhe *Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile* në fushën civile. Për këtë arsye, duke qenë se ka të dhëna lidhur me këtë tregues, dhe bazuar në mënyrën e pikëzimit që parashikon metodologjia, propozoj pikëzimin me 5 pikë.

Për sa i përket “Pjesëmarrjes së gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, vetëm për këtë të fundit ka pasur të dhëna, për shkak se përgjatë vitit 2019 gjyqtarja [...] ka qenë e caktuar si gjyqtare për median në juridiksionin e apelit Shkodër. Ndërkohë që, referuar të dhënave të tjera që lidhen me publikimin e Manualit të Standardeve Gjyqësore, etj., këto kanë qenë publikime dhe angazhime të gjyqtares që

janë tej periudhës së vlerësimit, për këtë arsye nuk janë marrë parasysh. Për këtë arsye, duke qenë se ka pasur të dhëna për angazhimin e gjyqtarës si gjyqtare për median, propozohet pikëzimi me 5 pikë për këtë tregues.

Për sa i përket publikimeve ligjore akademike, nuk ka të dhëna. Pikëzimi 0 pikë.

Përfundimisht për kriterin e katërt që është “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, pikëzimi 95 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Përfundimisht, niveli i përgjithshëm i vlerësimit i propozuar nga ana ime si relatore është 395 pikë, niveli "Shkëlqyeshëm".

Në pjesën e fundit të projektvendimeve janë përpiluar propozimet dhe rekomandimet të cilat i mëshojnë kryesisht angazhimit të gjyqtarës në trajnime, në botime dhe në veprimtari ndërinstucionale. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ftoj anëtarët e Këshillit nëse kanë diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, hedhim në votim projektvendimin përkatës të relatuar nga zonja Ukperaj.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës [...], për periudhën 2017-2019”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, të gjyqtarës [...], për periudhën 2017-2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95, pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.03.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017-2019”, relatore znj. Irena Plaku.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 15:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami* si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Rezarta Taushani dhe Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Të tjerë: Edmond Hoxhaj (BIRN).*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017-2019”, relatore *znj. Irena Plaku*.

Ilir Rusi: Për më tej, vazhdojmë me pikën 4 të rendit të ditës: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017-2019. Për më tej, fjala relatores *zonjës Plaku*.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë, po ju paraqes në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit për gjyqtarën {...}. Kjo e fundit është njoftuar rregullisht dhe ka deklaruar se nuk ka kundërshtime.

Po kaloj në mënyrë të përmbledhur në konkluzionet për secilin nga kriteret dhe nëntreguesit. Konkretisht tek kriteri i parë “Aftësia profesionale e gjyqtarit”, në treguesin

“Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”. Po kaloj direkt tek konkluzioni, duke qenë se jeni njohur dhe gjyqtarja nuk ka paraqitur kundërshtime.

Në tërësi, spikat aftësia e gjyqtarës për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecures së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen në trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsytimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se aftësia e gjyqtarës në këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

“Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, janë arsyetuar në mënyrë të përmbledhur ligji që ka zbatuar gjyqtarja si në vendimet penale ashtu edhe në vendimet civile; dispozitat procedurale të cilat ajo ka cituar; aftësia e saj për të përdorur jurisprudencën relevante të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së në lidhje me zbatimin e parimeve.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural, apo në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Po ashtu, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi rezulton kujdesi i shtuar i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, si dhe kujdesi për të referuar dhe

zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e gjyqtarës lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit.

Pas analizimit të të dhënave propozohet shkalla e aftësisë së saj për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

“Qartësia, koncizitetit dhe kuptueshmëria e vendimit” - Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkuese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Për këtë arsye aftësia e saj është propozuar shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

“Struktura se qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” - Në tërësi, gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme, të organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet, në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale dhe fakteve thelbësore të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, të cilat vijnë gjithnjë si pasojë e procesit të arsyetimit ligjor. Gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkuese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuar me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese. Pjesa përshkuese është e ndarë në disa nëntituj dhe në paragrafë.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të mirë organizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij, duke mundësuar lexim të organizuar dhe të strukturuar në rrjedhë logjike.

Pas analizimit të të dhënave, propozohet niveli i vlerësimit: Aftësia e saj për këtë

tregues është shumë e lartë, duke u pikëzuar me 10 pikë.

“Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik” –

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se aftësia e gjyqtarë për këtë tregues është shumë e lartë. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të vetë zhvillimit të mendimit juridik të gjyqtarës në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsytimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi i ligjit, si dhe mbështetja e tij në qëndrimet e praktikës gjyqësore, përpara zbatimit të tij mbi faktet konkrete. Arsytimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, në shërbim të zgjidhjes së çështjes.

Pas analizimit të të dhënave vlerësohet aftësia e gjyqtarës shumë e lartë, duke u pikëzuar me 25 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin e parë është 100 pikë, "Shkëlqyeshëm".

“Aftësia e gjyqtarës për të përballuar ngarkesën në punë”, “Respektimi i afateve ligjore” - Sipas të dhënave të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se nga 539 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 150 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati, ndërsa 389 çështje janë shqyrtuar brenda afatit ligjor. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (150 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 27,8 % të çështjeve jashtë afatit ligjor. Referuar pretendimeve të gjyqtarës të pasqyruara në formularin integruar të vlerësimit, është bërë edhe një herë rillogaritja dhe bërja e të dhënave statistikore, duke zbritur nga këto llogaritje lejen vjetore të muajit gusht prej 35 ditësh, për të cilën ligji parashikon 25 ditë punë, dhe festat e fundvitit. Pas rillogaritjes së secilës çështje, të dhënave statistikore, janë pasqyruar në mënyrë të detajuar ku është zbritur dhe pse janë zbritur ditët përkatëse dhe në ato raste kur nuk është zbritur. Për pasojë duke konsideruar shpjegimet e gjyqtarës lidhur me shortimin dhe planifikimin e çështjeve dhe tejkalimin e

afatit me 1 ose 2 ditë, i cili është konsideruar i pakonsiderueshëm, këto 24 çështje do të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor të parashikuar në ligj

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përlogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, përjashtohen çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë të shkurtër (deri në 2 ditë), raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (tashmë është zbritur në 126 çështje), me numrin total të çështjeve për të cilat ligji parashikon afat ligjor, rezulton se përqindja është 23.3 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor, përqindje që sipas metodologjisë vlerësohet me 9 pikë. Por për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara në tejkalim të afatit ligjor, që rezultojnë në masën 23.3% (ii) ngarkesën e gjyqtarës si relatore (në total për tre vite, nga të cilat 37.8 % janë me afat ligjore), duke gjykuar mesatarisht rreth 475 çështje në vit, nga të cilat 149.6 kanë qenë me afat ligjore, aspektet që lidhen me kushtet e punës, konkretisht angazhimin në trupa të tjera gjyqësore, është propozuar pikëzimi i saj me 12 pikë, duke konsideruar 11-20%.

“Plotësimi i standardeve minimale kohore” -

Referuar të dhënave të pasqyruara në raportin analitik rezulton se nga 886 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 140 prej tyre ose 15,8 % janë gjykuar tej standardit minimal kohor. Referuar pretendimeve të gjyqtarës, janë rillogaritur dhe përpunuar edhe një herë të dhënat statistikore dhe ka rezultuar nga numri i përgjithshëm 886 çështje janë zbritur 49 çështje të cilat janë konsideruar se janë përfunduar brenda afatit minimal kohor. Kështu përqindja tashmë, duke konsideruar numrin total të çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohor, ku tashmë nuk janë 140 çështje, por 91 çështje, ose 10,2 % e numrit total të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor. Kjo përqindje përkon me pikëzimin me 4 pikë.

Referuar burimeve të të dhënave, konkretisht ngarkesën e gjyqtarës, në pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e

vlerësimit, raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit minimal të çështjeve që rezulton 10,2%; faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit referuar shkaqeve të bëra prezent nga gjyqtarja në vetëvlerësimin e saj, të cilat përgjithësisht nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit dhe tejkalimin e standardit sasior të zbatueshëm me 150%, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal prej 5 pikësh.

“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” –

Janë marrë në analizë të gjitha kategoritë e çështjeve ku ka rezultuar se në kategorinë “tregtare me palë kundërshtare” është tejkaluar koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje krahasuar me standardin minimal kohor. Bazuar në pretendimet e gjyqtares, në faktin që standardi, është tejkaluar vetëm për një çështje, së cilës, në përlogaritje duhet t’i zbresim 20 ditë të njoftimit me letër porosi, periudhën e festave të fundvitit, do të konsiderohet më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 6 muaj.

Në lidhje me kategorinë e çështjeve “Penale-kundërvajtje”, ku rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 4 muaj e 5 ditë, duke e kaluar standardin minimal kohor të miratuar me vetëm 5 ditë, tejkalimi i cili vlerësohet si i papërfillshëm, për pasojë koha mesatare që i dedikohet çdo çështje do të konsiderohet më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 4 muaj.

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Referuar metodologjisë, duke qenë se shumicën e kategorive (10 nga 11), koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, përveç kategorisë “Penale-kundërvajtje”, ku standardi kohor është tejkaluar me vetëm 5 ditë, çka vlerësohet tejkalim i papërfillshëm, gjyqtarja propozohet të pikëzohet me 5 pikë.

“Rendiment i përfundimit të çështjeve” –

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, është 100,9% , e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 10 pikë.

Për këtë arsye, për këtë tregues është propozuar vlerësimi i saj me 10 pikë.

“Koha mesatare e arsyetimit të vendimeve” –

Referuar Raportit Analitik evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

Për civile të përgjithshme është më e shkurtër se afati procedural;

Për civile të përgjithshme pa palë kundërshtare është më e shkurtër;

Për familjare me palë kundërshtare është më e shkurtër se afati;

Për familjare pa palë kundërshtare është më e shkurtër se afati procedural;

Për tregtare është më e shkurtër.

Është bërë i gjithë analizimi, që mos t’i përmend të gjitha.

Nga 7 (shtatë) nën kategoritë e kategorisë “kërkesa penale të hetimit paraprak”, vetëm në dy prej tyre, koha mesatare e arsyetimit e ka tejkaluar afatin procedural.

Për nënkategorinë “kërkesa me objekt shtyrje e ekzekutimit të vendimit”, koha mesatare e arsyetimit është vetëm 0,5 ditë (pra disa orë) më e gjatë se afati procedural prej 5 ditësh, duke tejkaluar vetëm me 0.5 ditë e parashikuar në ligj, tejkallim që do konsiderohet i papërfillshëm.

Ndërkohë për dy nënkategoritë e tjera të kategorisë “kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë” koha mesatare e arsyetimit të vendimit është më e shkurtër se afati që parashikon ligji. Kështu, për çështjet e kategorisë “kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit do të vlerësohet është më e shkurtër se afati i parashikuar në ligj.

Nga të dhënat statistikore, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit është tejkaluar vetëm në nënkategoritë e çështjeve me objekt “caktim mase sigurimi” dhe “verifikim i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit”, por kjo e dhënë, duke iu referuar (i) shpjegimeve të gjyqtarës dhe të kryetarit të gjykatës lidhur me mënyrën e administrimit dhe dorëzimit të dosjeve lidhur me kërkesat me karakter sekret dhe (ii) parashikimeve të ligjit procedural penal i cili në nenin 244/1 dhe 248/2 të Kodit të Procedurës Penale parashikon disponimin e gjykatës më vendim të arsyetuar, nuk mund

të vlerësohet si e saktë. Kjo pasi koha e dorëzimit të dosjes gjyqësore, pas kalimit të afatit për ruajtjen e sekretit hetimor, nuk përputhet me kohën e arsyetimit të vendimit, e cila në kuptim të dispozitave ligjore të mësipërme, vlerësuar së bashku me shpjegimet e gjyqtarës, vlerësohet se ka qenë e barabartë me afatin ligjor.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar klasifikohet “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve” dhe gjyqtarja duke të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, me 15 pikë.

“Aftësia për të kryer procedurat gjyqësor” –

Bazuar në të dhënat e administruara, për treguesin “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtarë të përzgjedhura me short, rezulton se numri i seancave gjyqësore është 2.25 seanca dhe në çdo rast gjyqtarja ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të tyre. Për këtë arsye, për këtë tregues është vlerësuar aftësia e saj shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, në tërësi referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Për këtë tregues është propozuar aftësia e saj shumë e lartë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

“Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen” –

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik (sipas kategorisë) dhe kronologjike është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në

aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen lehtësisht.

Bazuar në sa më sipër vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 5 pikë.

Për sa i përket treguesit “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes”, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues. Në dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit apo prania e akteve/dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete. Për sa më lart është propozuar aftësia e saj shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Për kriterin e dytë “Aftësia organizative”, është bërë propozimi për 97 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” –

Janë administruar ankesat nga ILD-ja, nga ku ka rezultuar se nuk ka të dhëna për etikën e gjyqtarës. Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë përgjegjësie dhe është propozuar aftësia e saj shumë e lartë duke u pikëzuar me 35 pikë.

“Integriteti i gjyqtarit”, “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” –

Nga tërësia e burimeve të analizuara në vendimin e ILD-së, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarës, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtarës, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ-së rezulton se: Në përfundim të veprimeve verifikuese, në përputhje me ligjin “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare...”, në ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave...” si dhe ligjin “Për statusin”, konstatohet se për gjyqtaren {...} a) Deklaratat e

interesave private periodike janë dorëzuar brenda afateve ligjore; b) Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave private janë plotësuar në përputhje me ligji; c) Nga kontrolli i ushtruar është konstatuar konflikti i interesave, për çështje të veçanta, neni 21, pika 1, i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Ndalimi i lidhjes së kontratave”, për aq sa babai i subjektit, administrator i një shoqërie është shpallur fitues në procedurat e prokurimit publik dhe ka lidhur kontrata me institucionet publike. Ky vendim i ILDKPI-së është ankimuar në gjykatë dhe është shkruajtur edhe fakti që gjykata e ka shfuqizuar këtë vendim. Gjithashtu është marrë në analizë edhe vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit lidhur me këtë fakt i cili ka arsyetuar si më poshtë: Pasi analizoi kërkimet e Komisionerit Publik në ankim dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në periudhën kohore nga viti 2014 deri në vitin 2021, për shkak të kontratave të lidhura nga shoqëria tregtare, pronar i vetëm dhe administrator i së cilës është babai i subjekti. Pavarësisht nga ky konstatim, në rrethanat konkrete, faktet që rezultuan nga analiza e kryer në Kolegj, nuk mund të passjellin zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit për gjyqtarin.

Më poshtë ka arsyetuar: Duke abstraguar nga vendimi gjyqësor i sipërcituar (konkretisht vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë) dhe fakti që ligji nr. 9367 ka fushë veprimi vetëm funksionarët publikë dhe nëpërmjet tyre, personat e njësuar me ta, dhe ndalon shprehimisht kontratat publike, trupi gjykues i Kolegjit çmon se veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, pasi mori njoftim për gjendjen e konfliktit të interesit, kanë qenë gjithëpërfshirëse dhe krijojnë bindjen se kanë plotësuar gjithë nevojat për shmangien e këtij konflikti në të ardhmen.

Në raport është analizuar edhe vendimi gjyqësor.

Për sa më sipër, duke marrë në analizë të gjitha ato që janë analizuar në projektraport, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimit të metodologjisë së pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit në tërësi, masave të menjëhershme dhe gjithëpërfshirëse të ndërmarra nga gjyqtarja për shmangien e konfliktit të interesit, sapo ajo është vënë në

dijeni të ekzistencës së konfliktit të interesit, faktin se nuk konstatohet se gjyqtarja të ketë gjykuar çështje në konflikt të interesit, vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues. Pra është vlerësuar se aftësia e saj është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 40 pikë.

“Paanësia e gjyqtarit”, konkretisht për sa i përket treguesit “Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese”, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara. Pas analizimit të të dhënave propozohet aftësia e saj shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

“Numri tejet i lartë i kërkesave” –

Në vitin 2017, janë paraqitur 4 kërkesa për përjashtimin e subjektit të vlerësimit, të cilat janë rrëzuar. Ndërkohë, rezulton se vetë subjekti ka paraqitur 2 kërkesa për heqje dorë, të cilat janë pranuar.

Në vitin 2018, është paraqitur 1 kërkesë për përjashtimin e saj, e cila është rrëzuar. Ndërkohë që subjekti ka paraqitur 7 kërkesa të cilat janë pranuar.

Në vitin 2019, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për përjashtimin e subjektit të vlerësimit. Vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 2 kërkesa të cilat janë pranuar.

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, janë paraqitur 5 kërkesa për përjashtimin e saj, të cilat janë rrëzuar të gjitha, pra kërkesat e pranuar janë 0.

Sa më sipër, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar është i pakonsiderueshëm, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Propozimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është 100 pikë, “Shkëlqyeshëm”.

“Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, rezulton se komunikimi është i qartë dhe transparent. Për këtë është propozuar niveli i vlerësimit me 25 pikë.

“Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtja e të dhënave personale”, referuar

burimeve të vlerësimit nuk rezulton që gjyqtarja të ketë ceduar në ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ai është në dijeni për shkak të funksionit.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se shkalla e aftësisë në lidhje me këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

“Aftësia për të bashkëpunuar” –

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë. Për këtë arsye është propozuar vlerësimi i saj me 15 pikë.

“Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën”-

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj me 10 pikë.

“Pjesëmarrja e gjyqtares në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës” –

Ka rezultuar se gjyqtarja ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues në 24 aktivitete trajnuese të zhvilluara në të gjithë periudhën e vlerësimit. Konkretisht nga data 03.04.17 – 08.11.2019, gjithsej në 24 ditë trajnimi.

Për sa më sipër kjo kohëzgjatje është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë dhe është propozuar vlerësimi i saj me 20 pikë.

“Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët” –

Referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtarja subjekt vlerësimi nuk ka marrë pjesë si ekspert/lehtësues në programe të trajnimit fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e saj për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë. Referuar sa më sipër, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna që të jetë e angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësuese, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzimi i saj propozohet me 3 pikë.

Për sa i përket “Pjesëmarrjes së gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale”, referuar burimeve të pasqyruara në raportin analitik, është pasqyruar se nuk ka marrë pjesë, nuk ka të dhëna lidhur me këtë tregues.

Nga ana e saj, në lidhje me këtë tregues, gjyqtarja është shprehur se: “...për vitin akademik 2019-2020 kam marrë pjesë si pedagoge e jashtme në fushën e së drejtës penale, niveli "Master", pranë Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë” .

Sipas vërtetimit nr. {...} prot., datë 11.12.2019 i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, rezulton se gjyqtarja ka qenë personel akademik me kohë të pjesshme, për vitin 2018-2019, pranë Departamentit të Drejtësisë, Fakultetit të Shkencave Humane.

Referuar sa më sipër, duke qenë se rezultojnë të dhëna për gjyqtaren që të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe konkretisht në fushën e mësimdhënies, propozohet pikëzimi i saj me 5 pikë.

Sa i përket “Publikimeve ligjore”, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore, nuk rezultojnë të dhëna. Për sa më sipër propozohet pikëzimi i saj me 0 pikë.

Propozimi në tërësi për kriterin “Aftësia personale dhe angazhimi profesional i gjyqtares” është "Shkëlqyeshëm" me 93 pikë.

Propozimi i përgjithshëm për katër kriteret është si më poshtë:

“Aftësia profesionale e gjyqtares” 100 pikë;

“Aftësia organizative e gjyqtares” 97 pikë;

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” 100 pikë;

“Aftësia personale dhe angazhimi profesional” 93 pikë.

Vlerësimi i përgjithshëm është 390 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Gjithashtu në fakt është propozuar edhe rekomandimet sipas nenit 93 të ligjit “Për statusin”. Rekomandoj që gjyqtarja të mbajë në konsideratë angazhimin në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, kalojmë në votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017-2019”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, të gjyqtares {...}, për periudhën 2017-2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95, pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.03.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017-2019”, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 15:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami* si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani dhe Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Të tjerë: Edmond Hoxhaj (BIRN).*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017-2019”, relatore *znj. Brikena Ukperaj*.

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 5 të rendit të ditës që është: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017-2019. Relatore zonja Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Zoti {...} ka qenë edhe ai pjesë e programit të vlerësimit të miratuar për periudhën e vlerësimit 2017-2019. Gjyqtari është njoftuar për projektraportin e vlerësimit. Ka paraqitur kundërshtime vetëm për një nga treguesit, që ka të bëjë me “Disponueshmërinë e gjyqtarit dhe për pjesëmarrjen e tij në veprimtari ndërinstitucionale”. Ka paraqitur edhe një provë të re në kuadër të këtij treguesi. Nuk ka kërkuar të dëgjohet në seancë

dëgjimore.

Duke qenë se projektraporti i vlerësimit shoqërohet nga një raport analitik i detajuar për sa i përket përshkrimit të burimeve të vlerësimit, të dhënave dhe procesit analitik të analizës së të dhënave statistikore, unë do ndalem vetëm në konkluzionet për secilin nga treguesit e vlerësimit.

Për sa i përket “Aftësisë profesionale të gjyqtarit”. Gjyqtari është vlerësuar maksimalisht për kriterin e “Njohurive ligjore”, “Aftësisë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, pasi ka rezultuar se ka aftësi shumë të larta në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, paraqitjen e tyre në mënyrë koncize, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe referimin e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Pikëzimi 25 pikë. Shkallë shumë e lartë aftësie.

Për sa i përket “Aftësisë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” është konkluduar se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimit, identifikon dhe zbaton praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës. Shkallë shumë e lartë aftësie. Propozohet pikëzimi 25 pikë.

Për sa i përket “Qartësisë dhe koncizitetit”, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të larta edhe në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Shkalla e aftësisë shumë e lartë. Pikëzimi 15 pikë.

Për sa i përket “Strukturës së qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit”, në projektraport evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të larta edhe lidhur me këtë tregues, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor. Ai përdor një metodë të caktuar në strukturimin e vendimit të dukshëm si në aspektin vizual ashtu edhe në përmbajtje e cila, në varësi të kategorisë së çështjes apo natyrës së vendimit, përgjithësisht ndjek rregullin (i) fakt, (ii) ligj, (iii) arsytim dhe (iv) konkluzion. Shkallë shumë e lartë aftësie. Pikëzimi 10 pikë.

Për sa i përket “Cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik”, në tërësi analiza ligjore si në lidhje me aspektet procedurale të zhvillimit të gjykimit, mënyrën e marrjes së provave apo vlerësimin e atyre, ashtu edhe ajo ligjore e veprës penale ose objektit të kërkesës penale në shqyrtim, është një analizë e plotë dhe gjithëpërfshirëse, duke u pasuruar në disa raste edhe me interpretim të pavarur të ligjit si dhe qëndrime të praktikës gjyqësore. Shkallë shumë e lartë aftësie evidentohet për sa i përket këtij komponenti dhe nga analiza e vendimeve civile dhe përfundimisht, duke u bazuar në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit, pa i dhënë asnjë nga llojeve të çështjeve ndonjë rëndësi të veçantë, kam propozuar që për kriterin e parë të “Aftësive profesionale të gjyqtarit”, shkalla e aftësisë të jetë “shumë e lartë”, "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i përket “Respektimit të afateve ligjore”, nga analiza matematikore logjike, referuar edhe afateve të parashikuara në ligj, duke e konsideruar të parëndësishëm dhe pa peshë tejkalinin në afat ligjor me 1 apo 2 ditë, përfundimisht ka rezultuar që gjyqtari ka gjykuar në të gjithë periudhën 3-vjeçare 43 çështje nga 513 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, çka përbën vetëm 8.3% të çështjeve jashtë afatit ligjor, e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 15 pikë.

Për sa i përket “Plotësimin të standardeve minimale”, nga analiza matematikore logjike ka rezultuar që përqindja e çështjeve të shqyrtuara tej standardit minimal ka qenë 11.4%, çka sipas metodologjisë pikëzohet me 4 pikë. Por, bazuar po në metodologji, duke shmangur çështjet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, duke vlerësuar raportin e çështjeve për të cilat është marrë vendimi në tejkalin të afatit, me numrin total të çështjeve të gjykuara dhe tejkalinin e afatit vetëm me 1.4%, bazuar edhe në volumin e punës së gjyqtarit, kam propozuar që për respektimin e standardeve (duke marrë parasysh edhe natyrën orientuese të këtyre standardeve), të pikëzohet me një shkallë më të lartë se ai që i përkon 11.4%, duke u pikëzuar me pikë (pra shkalla deri në 0-10%).

Për sa i përket “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, ka rezultuar se koha mesatare është më e shkurtër për të gjitha kategoritë e çështjeve me përjashtim të një kategorie e cila është kategoria e çështjeve civile të përgjithshme me palë kundërshtare, ku koha është tejkaluar vetëm me 6 ditë dhe duke qenë vetëm 6 ditë e kam

konsideruar të papërfillshme për të zënë peshë në aftësinë e gjyqtarit dhe për këtë arsye edhe për këtë tregues kam vlerësuar që gjyqtari duhet të pikëzohet me 5 pikë, duke konsideruar të gjithë kohën mesatare të shqyrtimit të çështjeve të barabartë ose më të shkurtër se standardi minimal.

Për sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve”, në fakt rendimenti i përfundimit të çështjeve si raport midis çështjeve të gjykuara dhe çështjeve të caktuara rezulton brenda periudhës 3-vjeçare është 87%, përqindje e cila pikëzohet me 6 pikë.

Nga ana tjetër, gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë në formularin e tij të vlerësimit, duke pretenduar se shkaqet që kanë ndikuar në normën e ulët të likuidimit të çështjeve, ka qenë regjistrimi i një numri shumë të lartë të çështjeve në fund të vitit si dhe moskryerja e veprimeve në sistem nga administrata e gjykatës për rreth dy javë në fillim të çdo viti për shkak të procesit të mbartjes së dosjeve, njëkohësisht si edhe për shkak të pezullimit të çështjeve penale, për shkak të pamundësisë për të njoftuar të pandehurit e tjerë.

Nga analiza e të dhënave statistikore, bazuar në metodologji si dhe në Aneksin 1 të sistemit të vlerësimit të zbatueshëm, në rastin konkret për gjyqtarin, që nuk është i organizuar në seksione, rezulton që ai duhet të jetë relator në jo më pak se 200 çështje penale themeli dhe civile me palë kundërshtare. Ndërkohë, rezulton që gjatë vitit 2017 gjyqtari ka përfunduar 237 çështje me palë kundërshtare, duke tejkaluar standardin me 37 çështje ose 18 %; në vitin 2018 ka përfunduar 278 çështje me palë kundërshtare, duke tejkaluar me 78 çështje ose 39% standardin sasior; në vitin 2019 ka përfunduar 274 çështje civile, duke tejkaluar me 74 çështje ose 37 % standardin sasior. Ndërkohë në vitin 2019 prej datës 28.02.2019 ai ka ushtruar edhe detyrën e zëvendëskryetarit të gjykatës, për pasojë, për 10 muaj të vitit 2019, standardi sasior i zbatueshëm është 80 çështje në vit, ose 67 çështje për 10 muaj. Nëse do t'i referohemi këtij standardi sasior, për vitin 2019, rezulton se gjyqtari e ka tejkaluar standardin sasior me rreth 240% për periudhën 10-mujore, në të cilën ai ka ushtruar dhe detyrën e kryetarit në detyrë të gjykatës.

Në total për të tre vitet e plota të punës, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari ka përfunduar 789 çështje me palë kundërshtare, duke tejkaluar me 189 çështje ose me rreth

31% standardin sasior në fuqi. Duke përlogaritur periudhën 10-mujore të ushtrimit të detyrës së kryetarit, në raport me standardin sasior të zbatueshëm, rezulton se gjyqtari ka tejkaluar standardin sasior të zbatueshëm me 289 çështje, ose 58%.

Bazuar në këtë analizë logjike dhe matematike të përqindjes së çështjeve të shqyrtuara, në respektim të standardeve sasiore të përcaktuara, ku rezulton që e ka tejkaluar me mbi 50% si dhe bazuar në normën e rendimentit të llogaritur, kam propozuar që për këtë tregues të rritet me dy nivele, duke u pikëzuar me pikët maksimale, me 10 pikë.

Për sa i përket “Kohës mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor”, ka rezultuar më e shkurtër se afati për të gjitha kategoritë e çështjeve, pais ka pasur një tejkalim vetëm me 1 ditë për çështje “masë sigurimi”, për çështje “dërgim çështjeje në gjyq” me 3 ditë, dhe një tejkalim për “shtyrje ekzekutimi të vendimit”, tejkalime të papërfillshme që nuk zënë peshë në kohën mesatare të arsytimit të vendimit. Për këtë arsye kam propozuar pikëzimin me 15 pikë.

Për sa i përket “Numrit mesatar të seancave dhe shmangien e seancave joproductive gjyqësore joproductive”, numri i seancave është 1.6 seanca. Ka rezultuar që gjyqtari ka zbatuar me korrektësi ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile në pjesën e veprimeve paragjyqësore. Për këtë arsye pikëzimi është 15 pikë.

E njëjta gjë thuhet edhe për “Kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, që është pikëzuar me 20 pikë.

Për sa i përket “Rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes”, aktet renditen në mënyrë të tillë që të jenë lehtësisht të aksesueshme, janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen lehtësisht. Pikëzimi 5 pikë.

Për sa i përket “Saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit të dosjes”, në fakt dosjet janë të plota, por është konstatuar që në dosjet penale të mos jetë administruar “letra e të drejtave” e cila i bashkëlidhet njoftimit për të pandehurit, personit në hetim apo të dëmtuarit nga vepra penale, ndërkohë që komunikimi i saj me shkrim, bashkangjitur njoftimit për seancën gjyqësore është parashikuar në një sërë dispozitash të Kodit të Procedurës Penale. Pavarësisht se të drejtat e parashikuara nga nenet 34/a dhe 58 të

K.Pr.P subjekteve i janë garantuar duke iu bërë me dije edhe gjatë zhvillimit të gjykimit, mosadministrimi i kopjes me shkrim të këtij akti, bashkëlidhur kopjes së njoftimit që administrohet në dosjen gjyqësore dhe mospasqyrimi në këtë të fundit i komunikimit të letrës së të drejtave, përbën një të dhënë që duhet vlerësuar në drejtim të plotësisë së dokumentacionit të dosjes. Për këtë arsye kam propozuar që shkalla e aftësisë për këtë tregues të mos jetë shumë e lartë, por “mbi mesatare”, duke u pikëzuar me 8 pikë. Në asnjë dosje nuk kishte kopje të “letrës së të drejtave” të administruar.

Përfundimisht, për “Aftësitë organizative” pikëzimi 98 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, për të gjithë treguesit nuk ka pasur të dhëna që mund të afektojnë këtë gjë; nuk ka pasur asnjë kërkesë të pranuar për përjashtim; asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese. Përfundimisht është propozuar niveli i pikëzimit "Shkëlqyeshëm", 100 pikë.

Për sa i përket kriterit të katërt, propozohet nivel shumë i lartë për sa i përket komunikimit, respektimit të konfidencialitetit, shkallës së bashkëpunimit, shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Është propozuar pikëzimi maksimal.

Për sa i përket “Pjesëmarrjes në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, ka rezultuar se gjatë kësaj periudhe ka marrë pjesë në 10 aktivitete trajnuese të zgjatur në 20 ditë kalendarike, të cilat janë brenda marzhit të përcaktuar nga ligji (nga 15-120 ditë për tre vjet), duke u pikëzuar kështu me 20 pikë.

Për sa i përket “Disponueshmërisë për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional ose për trajnimin e gjyqtarëve”, nuk ka pasur të dhëna. Pikëzimi me 3 pikë.

Për sa i përket “Pjesëmarrjes në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata” ka rezultuar se nga burimet e vlerësimit nuk ka pasur të dhëna fillimisht. Ndërkohë, mbasi gjyqtari është njohur me projektraportin e vlerësimit, ka paraqitur kundërshtimet, ka

paraqitur edhe një vërtetim (vërtetim lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër”, ku midis të tjerash përcaktohet se: gjatë kësaj periudhe ku ka ushtruar detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, ka ndjekur një sërë praktikantësh, studentë në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, për ushtrimin e praktikës mësimore të tyre të detyrueshme (maj 2017 – qershor 2017, janar 2018 – shkurt 2018 – ju i keni këto, mos i lexoj). Vërtetimi është nr. 239 prot., datë 21.06.2022. Duke marrë parasysh një qëndrim të mëparshëm të Këshillit lidhur me një gjyqtare tjetër të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, e cila kishte paraqitur të njëjtin vërtetim me të njëjtat prova, ku Këshilli ia mori parasysh si veprimtari ndërinstitucionale, për të respektuar standardin, propozoj që të merret parasysh edhe në rastin e zotit {...} dhe pikëzimi për këtë tregues, nga 3 pikë të bëhet 5 pikë, duke qenë se ka të dhëna.

Për sa i përket “Publikimeve ligjore akademike” nuk ka pasur të dhëna. Pikëzimi me 0 pikë.

Përfundimisht, për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”, pikët 100, niveli "Shkëlqyeshëm".

“Aftësia organizative” 98 pikë, niveli "Shkëlqyeshëm";

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, niveli "Shkëlqyeshëm", pikët 100;

“Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, për shkak të provave të reja të administruara në seancë sot dhe pjesë e dosjes së vlerësimit lidhur me kontributin për veprimtari ndërinstitucionale, propozoj që nga 91 pikë, të shkojë në 93 pikë, pra t'i shtohen 2 pikë në treguesin përkatës që është “4Cc”.

Niveli i përgjithshëm që propozohet është 391 pikë (389 dhe 2 pikë të tjera që shtohen), niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime për sa u parashtrua nga relatorja për rastin në fjalë?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, kalojmë në votimin e projektvendimit duke vlerësuar edhe propozimet e bëra nga vetë relatorja.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017-2019”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017-2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95, pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.03.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 15:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |

8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami* si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani dhe Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Të tjerë: Edmond Hoxhaj (BIRN).*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, për kandidaten *znj. {...}*”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. *Dritan Hallunaj*).

Ilir Rusi: Për më tej vazhdojmë me pikën 6 të rendit të ditës. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, për kandidaten *znj. {...}*”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës. Për më tej, fjala relatorit z. *Hallunaj*.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Po parashtoj relacionin për tërheqjen e znj. {...} nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me këtë vendim të sipërcituar është hapur procedura për ngritjen në detyrë Gjykatës së Apelit në fushën e të drejtës penale.

Në vijim të procedurave është lënë një afat i caktuar në faqen e internetit të KLGJ-së, afat i cili përfundonte më datë 5 dhjetor 2022. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar znj. {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Më tej Këshilli ka vijuar me procedurat e mëtejshme, duke hedhur shortin dhe duke listuar personat. Në vijim të vendimmarrjes së këtij Këshilli kanë filluar procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore për ngritjen në detyrë si dhe në pikën e dytë ka të bëjë me caktimin e relatorit, i cili jam caktuar unë për kandidaten znj. {...}.

Më tej është njoftuar në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, është njoftuar kandidatja për për fillimin e procedurës së verifikimit, caktimin e relatorit, të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin, etj. Brenda këtij afati kandidatja nuk ka parashtruar ndonjë pretendim në lidhje me relatorin apo me ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu është ftuar kandidatja që të plotësojë të gjithë dokumentacionin që do dorëzohej prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve.

Në vijim të verifikimit të tre kriterëve ligjore të kandidimit si dhe plotësimin të dokumentacionit, kandidatja znj. {...}, me shkresën e datës 02.03.2023 protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga kandidimi për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke parashtruar se: “Nëpërmjet kësaj kërkesë heq dorë nga kandidimi për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Në këto rrethana, duke pasur parasysh edhe bazën ligjore, vendimin e KLGJ-së në

të cilin përcaktohet se kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit”.

Në këto kushte, duke e vlerësuar të rregullt procedurën e verifikimit të ndjekur deri në këto momente për kandidaten znj. {...}, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, unë i parashtrova Komisionit të Zhvillimit të Karrierës çështjen dhe në datën 09.03.2023, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke e konsideruar të rregullt procedurën e verifikimit për kandidaten si dhe po ashtu, vlerësoi të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidatja për t’u tërhequr nga kandidimi, vendosi që të dërgojë çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar ky i fundit për përfundimin e kësaj procedure ngritjeje në detyrë, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hallunaj!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.03.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 15:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |

8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)

9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami* si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Rezarta Taushani dhe Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

4. *Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*

5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*

6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

7. *Të tjerë: Edmond Hoxhaj (BIRN).*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Dritan Hallunaj).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 7 të rendit të ditës. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, për të cilin

është përgatitur relacioni përkatës. Për më tej, fjalën z. Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Po parashtroj relacionin për tërheqjen e znj. {...} nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr.503 datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me vendimet e sipërcituara, pra 502, 503 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur “Hapja e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, në fushën e të drejtës penale” dhe “Hapja e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës në fushën e të drejtës penale”.

Brenda afatit të përcaktuar në rregullore dhe në ligj është bërë shorti, ku janë përcaktuar relatorët për çështjen dhe për rastin konkret relator i çështjes kam qenë unë.

Pastaj janë vijuar procedurat për sa i përket verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit si dhe të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit ose ndonjë anëtar tjetër të Këshillit, të cilat kanë ardhur negative, pasi nuk ka pasur ndonjë pretendim të tillë.

Në vijim të procedurave të verifikimit, sipas komunikimit elektronik të datës 07.03.2023, kandidatja znj. {...} ka paraqitur një kërkesë, të protokolluar në Këshill me nr. {...} prot., nëpërmjet së cilës heq dorë nga kandidimi për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në këto kushte, duke pasur parasysh bazën ligjore si dhe vendimin e Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, në të cilin shprehimisht thuhet se: Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit.

Në këto kushte është dërguar akti për t’u miratuar pranë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe ky Komision, në mbledhjen e datës 09.03.2023 ka parashtruar duke

vendosur dërgimin e çështjes për shqyrtim Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të vlerësuar ky i fundit për përfundimin e kësaj procedure ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hallunaj!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me hedhjen në votim të projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këto pozicione.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit

98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.03.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 501, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 15:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |

8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)

9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami* si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Rezarta Taushani dhe Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

4. *Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*

5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*

6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

7. *Të tjerë: Edmond Hoxhaj (BIRN).*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 501, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Dritan Hallunaj).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 8 të rendit të ditës. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 501, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i cili është përgatitur relacioni përkatës. Për më tej fjalën zotit Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Atëherë po parashtroj relacionin për tërheqjen e znj. {...} nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 501, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me vendimin e sipërcituar, pra me vendimin nr. 501 është vendosur hapja e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Është lënë afati i përcaktuar në ligj, deri në datën 15.12.2022 për kandidimin dhe brenda këtij afati ka kandiduar edhe kandidatja znj. {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

Më tej janë vijuar procedurat për sa i përket shortimit/përcaktimit të relatorit të çështjes, në të cilën jam caktuar unë.

Në vijim janë kryer të gjitha procedurat sipas bazës ligjore të përcaktuar, që përfshin njoftimin për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve dhe kushteve, caktimin e relatorit, ndonjë shkak dorëheqjeje apo të drejtën që kishte për përjashtimin e secilit nga anëtarët, e cila ka rezultuar negative dhe nuk ka parashtruar ndonjë pretendim në lidhje me relatorin si dhe procedurën e verifikimit apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit.

Në vijim të procedurave, kandidatja znj. {...}, me anë të shkresës së protokolluar në Këshill me nr. {...} prot., datë 06.03.2023 ka paraqitur kërkesën për heqje dorë nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar duke parashtruar se: “Nëpërmjet kësaj kërkesë heq dorë nga kandidimi për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 501, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Duke pasur parasysh vendimmarrjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, ku thuhet shprehimisht: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar

menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor”, dhe kështu është vepruar, i jam drejtuar Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe ky Komision më datë 09.03.2023, duke konsideruar të rregullt procedurën e verifikimit paraprak të ndjekur për kandidaten si dhe po ashtu vlerëson qartë edhe vullnetin e shfaqur nga kandidatja për t’u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vendosi që t’i drejtohet Këshillit dhe të ishte ky i fundit ai që do shprehej për përfundimin e procedurës për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hallunaj!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, po vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 501, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e së Posaçme të

Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 501, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.03.2023)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 07.07.2022”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 15:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

9. Yllka Rupa

(anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami** si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Rezarta Taushani dhe Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Të tjerë: Edmond Hoxhaj (BIRN).**

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 07.07.2022”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 9 të rendit të ditës. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 07.07.2022”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës. Për më tej fjalën relatores znj. Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Projektvendimi që i paraqitet sot mbledhjes plenare është i diktuar nga rrethanat që kanë ndodhur së fundi lidhur me vendimmarrjet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bëhet fjalë për gjyqtaren udhëheqëse znj. {...} e cila është shkarkuar me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe për pasojë është pezulluar nga detyra, çka e bën të pamundur objektivisht që ajo të ushtrojë detyrën e magjistratit udhëheqës për sesionin e tretë 4-mujor mars 2023 – qershor 2023.

Për këtë arsye, Komisioni i propozon plenares zëvendësimin e saj me një gjyqtar tjetër. Por duke qenë se gjatë kësaj periudhe, pranë gjyqtares {...} kanë qenë të caktuar dy kandidatë për gjyqtarë, është e nevojshme që secili prej tyre të caktohet pranë një gjyqtari udhëheqës tjetër.

Në fakt, siç e shikoni nga lista bashkëngjitur relacionit, aktualisht mbeten vetëm 7 gjyqtarë të dhomës penale, të cilët janë përfshirë në listën e magjistratëve udhëheqës, nga të cilët shumica prej tyre kanë nga dy magjistratë (*kandidatë për gjyqtarë*).

Për këtë arsye, për të barazuar pothuajse të gjithë gjyqtarët, kemi propozuar që për znj. {...}, kandidate për gjyqtare, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, në vend të zonjës {...}, të caktohet në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës zonja Vjollca Spahiu dhe për kandidatin për gjyqtar z. {...}, të caktohet në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës për sesionin e tretë 4-mujor, znj. {...}.

Në këtë mënyrë, të gjithë gjyqtarët e seksionit, pothuajse, kanë nga dy kandidatë për gjyqtarë në mentorim.

Në këto kushte është hartuar edhe projektvendimi, në pikën e parë të të cilit parashikohet pikërisht ajo që unë relatova, ndryshimi i listës së gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e KLGJ-së nr. 252, datë 07.07.2022 (i cili sipas relacionit rezulton që të jetë ndryshuar disa herë dhe të jetë përditësuar në fakt, për shkak edhe të pamundësive objektive të gjyqtarëve), gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, duke zëvendësuar gjyqtaren udhëheqëse znj. {...} me gjyqtarët: (i) znj. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidates për magjistrate znj. {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars 2023-qershor 2023); znj. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magjistrat z. {...}.

Në pikën e dytë është parashikuar njoftimi i vendimit Shkollës, Gjykatës së Tiranës dhe gjyqtarëve respektivë që do të hyjnë në mentorim.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime nga anëtarët për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 07.07.2022”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Ndryshimin pjesërisht të listës së gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 07.07.2022, gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022-2023, duke zëvendësuar gjyqtaren udhëheqëse znj. {...} me gjyqtarët:

(i) znj. Vjollca Spahiu, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidates për magistratë znj. {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars 2023-qershor 2023);

(ii) znj. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magistrat z. {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars 2023-qershor 2023).

2. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Tiranë dhe gjyqtarëve znj. {...} dhe znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.03.2023)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 15:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|---------------------------------|
| 1. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 3. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Dritan Hallunaj | <i>(anëtar)</i> |
| 5. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 6. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Marçela Shehu | <i>(anëtare)</i> |
| 8. Brikena Ukperaj | <i>(anëtare)</i> |

120

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 15.03.2023 (Pika 10)***

9. Yllka Rupa

(anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami* si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Klodian Kurushi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Rezarta Taushani dhe Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Të tjerë: Edmond Hoxhaj (BIRN).

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Yllka Rupa).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 10 të rendit të ditës. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës. Për më tej fjala relatores znj. Rupa.

Yllka Rupa: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parashikimet e nenit 85 e vijues të Ligjit nr.

96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe vendimin nr. 645, datë 23.12.2020 “Programi i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2021”, me vendimin nr. 371, datë 13.09.2022, ka vendosur fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarin {...}, për periudhën e vlerësimit 2017-2019.

Gjatë ecures së procedurës së vlerësimit të gjyqtarit, ka rezultuar se Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin nr.169, datë 02.03.2023 ka vendosur:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 519, datë 25.03.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. {...}.

2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

Në pikën 7, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se: “Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë”. Ndërsa në nenin 66 të Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: “Vendimi i Kolegjit të Apelit, që vendos shkarkimin nga detyra, ka efekt të menjëhershëm”. Më tej, neni 164 i Ligjit për Statusin, në dispozitat e tij kalimtare, përcakton se: “1.Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse: ...b) kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë””.

Sipas parashikimeve ligjore në fuqi, vendimi i këtij organi kushtetues për dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, është një vendim, pasojat juridike të së cilit kanë efekt të menjëhershëm, duke përbërë shkak për mbarimin e menjëhershëm të statusit të magjistratit.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit të gjyqtarit {...} passjell mbarimin e menjëhershëm të statusit të magjistratit, rrethanë kjo që përbën shkak për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit.

Në ligjin nr. 96/2016 nuk ka një parashikim të shprehur për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional pa vendim përfundimtar, ndërkohë që në nenin 7 të vendimit të KLGJ-së nr.263, datë 21.11.2019, parashikohet përfundimi pa vendim përfundimtar i procedurës së vlerësimit në rastet e mbarimit të statusit të gjyqtarit.

Sa më sipër, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe situatën faktike të parashtruar më sipër, Komisioni vlerësoi se për ish/gjyqtarin {...} duhet të deklarohet përfundimi i procedurës së vlerësimit pa vendim përfundimtar, sepse si objekti ashtu dhe qëllimi i kësaj procedure vlerësimi është bërë i pamundur për t'u realizuar.

Në referim të analizës së mësipërme, Komisioni propozon miratimin e projektvendimit përkatës, në të cilin është përcaktuar si vijon:

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet përfundimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...}, për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet që një kopje e vendimit për përfundimin e procedurës së vlerësimit t'i njoftohet gjyqtarit {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në pikën 3 të projektvendimit parashikohet e drejta e ankimit në gjykatë ndaj këtij akti administrativ individual të Këshillit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Illir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarin {...}, për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit.

2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 15.03.2023)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datave 31.01.2023, 01.02.2023, 09.02.2023 (2 mbledhje), 13.02.2023, 16.02.2023, 23.02.2023 (2 mbledhje).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 15:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami* si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli**, Sekretar i Përgjithshëm.
2. **Luan Dibra**, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.
3. **Rezarta Taushani dhe Maela Alicanaj**, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.
4. **Valbona Bala**, eksperte (EWMI-INL).
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi**, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.
6. **Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
7. **Të tjerë: Edmond Hoxhaj (BIRN).**

RENDI I DITËS:

11. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datave 31.01.2023, 01.02.2023, 09.02.2023 (2 mbledhje), 13.02.2023, 16.02.2023, 23.02.2023 (2 mbledhje).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 11 të rendit të ditës. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datave 31.01.2023, 01.02.2023, 09.02.2023 (2 mbledhje), 13.02.2023, 16.02.2023, 23.02.2023 (2 mbledhje).

Keni diskutime mbi përmbajtjen e procesverbaleve?

(Nuk ka diskutime).

Kalojmë në votimin e tyre.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 31.01.2023, 01.02.2023, 09.02.2023 (2 mbledhje), 13.02.2023, 16.02.2023, 23.02.2023 (2 mbledhje).

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Doja të theksoja faktin që përgjatë gjithë mbledhjes, që nga momenti i fillimit deri më tani, edhe zoti Kurushi nuk ka qenë prezent në mbledhje për shkaqe objektive.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Pasdite të qetë!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor